

**MOS KINI FRIKË NGA SHQIPONJA**



Llogaria në ALL 0001356492  
IBAN AL03202110370000000011356492  
Llogaria në Euro 0011356492  
IBAN AL85202110370000000011356492

Alternativat  
tjera janë të  
dëmshme



Më mirë  
një Valon i  
zakonshëm në  
Mitrovicë, sesa  
një yll futbollit  
në Zvicër



# Koha



**Libri "Urtësi  
e Marrëzi" –  
Bajrush Mjaku**

EDITORIAL

**Thelbi i  
qenësisë në  
një shoqëri  
të ndarë**



Merre si ta marrësh, maqedonasit e kanë patjetër të kthehen te shqiptarët, jo vetëm për të përballuar me lehtë sfidat që vijnë nga jashtë, por edhe për të përjetuar në lëkurë teknologjinë e nivelizimeve brenda një ofiçine ku të gjithë futen me idetë e mëdha nacionale dhe dalin prej andej me puplat e lagura të klonimeve inxhinjerike social-globaliste.

MAQEDONI-BE

**Në pikëpyetje  
çelja  
e negociatave**

KRONIKË

**Në Gjermani  
kosovari  
vret gruan  
me sëpatë**



## INTEGRITETI I TË BURGOSURVE NUK RESPEKTOHET

# KAOSI NË BURGJE

# VAZHDON



**Krahas sjelljes së ulët të gardianëve, ekipi i MPN-së, ka mbledhur informacione se në burgun e Shutkës ekzistonjnë indicie për korrupsion, posaçërisht kur bëhet fjalë për shitjen e celularëve dhe vendosjen personave në hapësira ky sinjali i rrjetit të telekomunikimit nuk është i bllokuar. Për këto arsye ato apelojnë që institucionet përkatëse t'i analizojnë dhe hetojnë rastet e tilla**

## Avokati i shtetit, vetëm një shqiptar

Shkup, 26 qershor- Që nga zgjedhja e Naser Ajdari si gjykatës kushtetues nga 5 marsi këtij viti, injorimi, neglizhenca dhe mobingu klasik nga ana e udhëheqësisë njëqind përqind maqedonase të këtij institucioni ka vazhduar njëjtë siç kishte ndodhur para se te emërohej avokat shtetëror shqiptar. Procesi i filluar i avancimeve graduale stagnoi dhe çdo ditë nëpunësit shqiptar degradohen, pengohen në

punë me imtësira banale dhe ushtrohet mbi ta mobing i llojit më të ulët sikur të ishin bonjak pa një tutor apo prind", ky është reagimi në formë të shkruar i nëpunësve shqiptar të Avokatit të shtetit drejtuar mediave. Siç shtojnë ata këto muajt e fundit egziston vakum kohor për zgjedhjen e avokatit të ri shtetëror të Republikës së Maqedonisë dhe avokat shtetëror të njësisë rajonale të Shkupit...



## EDITORIAL

## THELBI I QENËSISË NË NJË SHOQËRI TË NDARË



Emin AZEMI

Merre si ta marrësh, maqedonasit e kanë patjetër të kthehen te shqiptarët, jo vetëm për të përballuar me lehtë sfidat që vijnë nga jashtë, por edhe për të përjetuar në lëkurë teknologjinë e nivelizimeve brenda një ofiçine ku të gjithë futen me idetë e mëdha nacionale dhe dalin prej andej me puplat e lagura të klonimeve inxhjinjerike social-globaliste.

Ndarjet në shoqërinë maqedonase, pas nënshkrimit të Marrëveshjes Athinë – Shkup, a janë vetëm shprehje e qëndrimeve të kundërta në mes të përfaqësuesve të ndryshëm të komuniteteve elitare, apo kjo ndarje ka prekur edhe më thellë gjithë këtë shoqëri? Ende s'është bërë ndonjë hulumtim i opinionit publik për të vërtetuar këto dilema e hamendësime, por ajo që është e sigurt - referendumit i paraparë për në vjeshtë do ta gjej shoqërinë maqedonase më të përçarë se kurdoherë. Nëse Referendumi për pavarësi (8 shtator 1991) kishte prodhuar një mobilizim masiv të popullatës etnike maqedonase për mëvetësinë e shtetit të munguar, tani e njëjta popullatë do të duhej ta shprehë një disponim krejt tjetër për të njëjtin shtet, por me një emër tjetër. Kauza e dikurshme për pavarësi, tani po shndërrohet në kosto për të faturuar iluzionet e gabuara mbi të cilat u ndërtua projekti i dyzuar i shtetit me përmasat e një sfinje me trajtë antike e sllave (!).

Fati i shqiptarëve në këtë parabolë historike vazhdon të ndjekë një ritëm konstant, pa ngritje dhe ulje drastike të parametrave psiko-social në disponimin e tyre publik. Shqiptarët, për dallim nga bashkëqytetarët e tyre sllavë, ndjekin si me inerci një dinamikë tjetër të ndryshimeve, në shikim të parë mjaft inerte, por nëse vështrohet pak më thellë, del të jetë një qëndrim pak a shumë i natyrshëm dhe konsistent në mosofrim të zgjidhjeve kreative. Shqiptarët si ushtarë besnikë të status-quo disa kanë dëmtuar jo rrallë muret e brendshme të mirëqenies së tyre nacionale, por kanë ruajtur (ndoshta edhe pa vetëdije) muret e jashtme të ngrehinës së asaj që quhet shtet i përbashkët. Ndryshe nga ata, maqedonasit u munduan të konsolidojnë muret e brendshme të mirëqenies nacionale, paçka se doli që ato mure kishin qenë prej dërrasë gipsi me licenca antike e sllave, kurse sa për kujdesin ndaj mureve të jashtme (paradoksalisht) ngeli të jetë barrë vetëm e shqiptarëve.

Ajo çka është e papranueshme për shoqërinë maqedonase, nuk konsiderohet me automatizëm e pranueshme për shqiptarët, por në thelb ekziston një koherencë e papajtueshmëri që në instancë të fundit nuk shprehet në formë platformash, por vetëm si animozitete dhe mosdurime latente. Vetëm viti 2001 ishte vendimtar për të shënuar kthesën dhe për herë të parë shqiptarët e maqedonasit u gjendën aksidentalisht në pikën zero, prej ku pastaj, secili për llogari të veten, projektoi botën e perceptimeve pak a shumë të ngjyrosura me hilet e po-

litikës së ditës. Ndryshimi i imponuar si rrjedhojë e kryengritjes së armatosur, do të duhej të sillte rezultate edhe më të mëdha në rekapitullimin e bilancit politik të të arriturave të shoqërisë shqiptare dhe kjo do të duhej të ndodhte patjetër sikur të mos kishte prirje që dinamikën e aksionit politik ta shndërronte në diskurse disi të vetëmjaftueshmërisë.

Nëse ndarja në mes të shqiptarëve dhe maqedonasve pas 2001-shit ishte shprehje e senzibiliteteve të ndryshme konstitucionaliste, me ç'rast Marrëveshja e Ohrit për njërin palë shihej si atribut i avancimit substancial, kurse për palën tjetër si katastrofë nacionale, tani po ndodhë një ndarje tjetër brenda vetë shoqërisë maqedonase, e cila në thelb ka si lajtmotiv sërish sensibilitetin konstitucionalist, por me një konotacion tjetër që të përkujton kohën "kur të gjithë ishim shqiptarë". Ikja për t'mos patur fatin e shqiptarit nga ana e maqedonasit të thjeshtë në shtetin që ata e konsiderojnë "të tyre", do të përkthehej edhe si një katarsë tragjikomike e një pjesë të një shoqërie me elitë që intensitetin e zgjimit nacional ende e mat me reduktimin apo zgjerimin e të drejtave të shqiptarëve. Merre si ta marrësh, maqedonasit e kanë patjetër të kthehen te shqiptarët, jo vetëm për të përballuar me lehtë sfidat që vijnë nga jashtë, por edhe për të përjetuar në lëkurë teknologjinë e nivelizimeve brenda një ofiçine ku të gjithë futen me idetë e mëdha nacionale dhe dalin prej andej me puplat e lagura të klonimeve inxhjinjerike social-globaliste.

Evropa e nesërme në gjiun e saj do ta ketë edhe një fëmijë që ecjen në tokë e mëson duke ndjekur më tepër një algoritmë rrethanash gjeopolitike, se sa ndonjë nevojë imediate të brendshme për të qenë me automatizëm secili vetvetja. Dalja nga vetvetja dhe futja në lëkurën e tjetrit mund të jetë një kualitet i ri në procesin e faktorizimit si shtet me imazh tjetër, jo vetëm gramatikor, por edhe politik e juridik. Askush nuk garanton se ky tëhuajsim mund të jetë edhe shkas për pengesa të reja që e bëjnë më të vështirë këtë proces.

Nëse dje ishte Greqia pengesë për mos anëtarësim në BE dhe NATO, tani mund të jenë vetë qytetarët e këtij shteti kidnapues të ardhmërisë së tyre. Referendumi është një sprovë ku shqiptarët do të duhej edhe njëherë të dëshmojnë se janë musketarë të një "mbretërie" ku arsyeja e së ardhshmes e jo iracionaliteti i së shkuarës është thelbi i kuptimit të qenësisë dhe prezencës së tyre. Dhe, kuptohet këtu nuk përfundon gjithçka.

## Pasojat e mosdijes

"Kam vite të tëra që gjendem mes nxënësve dhe studenteve e kam botuar edhe libra për shkak të lidhjes së fortë që ndërtova me ta. Por ka ca kohë që me keqardhje vë re që po formatohet një brez i ri dembel, injorant, mendjemdhenj, me vetbesim pa baza, që nuk e duan shkollën as punën, që i duan gjërat gati, brez i ri që shpenzon kohën produktive në rrjetet sociale pa rezultat por me selfie e karshillëk ndaj njëri-tjetrit, gjimnazistë me shifra të frikshme ngelës në gjuhën shqipe, studentë që në bachelor vazhdojnë mbetës disa vite dhe nuk bëjnë përpjekje minimale për përmirësimin e rezultateve të tyre që të jenë konkurent dinjitoz për në master apo nesër në tregun e punës, Unë e kam mbështetur gjithnjë brezin e ri ama prej disa kohësh shikoj një ndryshim shumë të madh me vitet kur jepja mësim në gjimnaz, dhe në vitet e para si pedagogje, tani po vijmë në universitet nxënës të dobët, ndonjëherë dhe me mesatare të lartë por të pajustificuar fare me dijen përkatëse, ku po shkon kjo rini, niseni nga vetja vajza dhe djem shqiptarë sepse brezi im dhe shumë më të mëdhenj se unë, edhe kur janë me dy palë syze për afër dhe larg, vazhdojmë e studiojmë akoma që të përballojmë sfidat e kohës, dhe e mbajmë librin pranë vetes gjithnjë, madje e kemi dhe te koka e krevatit ku në momentin që bëhemi gati për gjumë i kalojmë 2-3 faqe së lexuari ... Koha për reflektim nga prindërit, shkolla dhe shoqëria, ndryshe pasojat e mos dajes dhe të mungesës së dëshirës nga të rinjtë janë në rritje dhe fatale për të ardhmen...", shkruan në profilin e saj në Facebook, pedagogia universitare nga Tirana, Xhoi Jakaj.

## MOS KINI FRIKE NGA SHQIPONJA

"MOS KINI FRIKE NGA SHQIPONJA është emri i llogarisë bankare ku gjithkush mund të japë një kontribut simbolik, për të paguar gjobën absurde të FIFA-s ndaj Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirrit Shenja e duarve shqiponjë është shenja jonë dalluese e komunikimit në raste gëzimi dhe me keqardhje për ata që e keqinterpretuan shenjën e gëzimit krejt spontan nga një moment i bukur sportiv, në Raiffeisen Bank është hapur llogaria MOS KINI FRIKE NGA SHQIPONJA Kjo llogari u hap falë nxitjes së shumë miqve të këtij rrjeti social nga e gjithë bota, si falenderim e mirënjohje për dy sportistët që ngritën peshë në një gëzim sportiv miliona shqiptarë", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama

## KUVENDI I DIBRËS?

Kuvendi i Dibrës u mblodh më 1 nëntor 1878 nën kryesinë e Iljaz Pashë Dibrës, në të cilin mori pjesë edhe Abdyl Frashëri me cilësinë e përfaqësuesit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Toskërinë. Kuvendi i Dibrës miratoi rezolutën në trajtë memorandumit, e cila përmbante 5 pikat që shtroheshin në programin e Komitetit të Stambollit: formimi i vilajetit të Shqipërisë, krijimi i administratës me nëpunës shqiptarë, zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe, zbatimi i reformave nga Kuvendi i Madh, përdorimi i një pjese të konsiderueshme të buxhetit për përparimin e arsimit dhe për ndërtim botore. Rezoluta iu paraqit Portës së Lartë në fillim të shkurtit 1879.



NËSE NUK E KENI DITUR...

PROCESI EUROINTEGRUEES

# NË PIKËPYETJE ÇELJA E NEGOCIATAVE

Nuk përjashtohet asnjë variant në këtë moment: fillim i kushtëzuar i reformave, anulim i vendimit ose fillim i procesit të skriningut gjatë javëve ose muajve të ardhshme. - Kryeministri i Zoran Zaev, të martën u ka dërguar letër të hapur liderëve të vendeve anëtare të BE-së, përmes së cilës ju bënë thirrje që të mbështesin nisjen e negociatave për Maqedoninë me BE-në



Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 26 qershor- Franca dhe Holanda vazhdojnë të kundërshtojnë për hapje të negociatave për momentin me Maqedoninë. Parisi dhe Amsterdami, drujnë se çfarëdo lloj fillimi i negociatave me vende tjera kandidate do të kishte efekt negativ ndaj opinionit të tyre vendor, andaj do të donin që fillimi i negociatave me Shkupin dhe Tiranën të shtyhet deri pas zgjedhjeve evropiane në pranverë të vitit 2019, kështu thonë për Agjencinë e lajmeve MIA-n burime diplomatike në Këshillin e BE-së. Siç raportin MIA nga Brukseli, edhe Franca edhe Holanda janë të vetëdijshme se pas Marrëveshjes për emrin me Greqinë duhet t'i ofrohet Maqedonisë, posaçërisht duke pasur parasysh referendumin e ardhshëm. Megjithatë, vendet e tjera anëtare, dhe posaçërisht Gjermania, insistojnë se opinioni francezo-holandez nuk është i mirë. Ministrat në këtë moment mbajnë diskutime joformale në Luksemburg, brifojnë burimet diplomatike. Sot në mëngjes filloi me zgjerimin, secili vend e prezantoi qëndrimin e vet. Para fillimit të takimit, disa ministri i paralajmëruan pozicionet e veta fillestare. Ministri holandez i Punëve të Jashtme, Stef Blok deklaroi se për vendin e tij është me rëndësi të shohë dëshmi se reformat janë implementuar në mënyrë të qëndrueshme dhe se për atë nevojitet kohë.

## GJERMANI I DEL NË KRAH MAQEDONISË

Ministri gjerman për Evropë, Majkell Rot, porositi se shpreson se do të arrijë t'i bindë Francën dhe Holandën të mos e bllokojnë fillimin e negociatave me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Ndërkaq, ministri i Jashtëm i Luksemburgut, Zhan Aselbom deklaroi se moshapja e negociatave me Maqedoninë do të ishte "gabim politik". Tema i polarizoi thellësisht vendet anëtare të atyre të cilat janë për dhe atyre që

janë kundër. Edhe pse të dytë janë të paktë nevojitet konsensus për fillim të negociatave. Nuk përjashtohet të mos arrihet marrëveshje sot dhe tema t'u dërgohet shefave të shteteve dhe qeverive të BE-së të enjten. Disa opsione janë në tryezë në mënyrë që të gjendet kompromis me Francën, si për shembull të jepet dritë e gjelbër për të filluar së shpejti procesi i kriningut, ndërsa data për negociata të përcaktohet më vonë. Një grup i eurodeputetëve, të cilët gjithashtu janë raportues dhe kryetar të delegacioneve në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë dërguar letër të hapur për shefat e shteteve të BE-së, prej të cilëve kërkojnë që në mbledhjen e Këshillit të Evropës më 28 dhe 29 qershor të merren "vendime të guximshme" për nisjen e negociatave për integrimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Tanja Fajon, Knut Fleckenstein, Eduard Kukan, Monica Macovei, David Martin, Alojz Pedelle, Tonino Picula, Cristian Dan Preda, Igor Soltes, Charles Tannock, dhe Ivo Vajgl në letër theks të veçantë i japin marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë, e cila siç thonë ka hapur perspektivë për Evropën. Ata u bëjnë thirrje udhëheqësve evropianë që të demonstrojnë përkushtimin e tyre të qartë ndaj perspektivës evropiane për gjithë rajonin, duke rënë dakord të hapin negociatat e pranimit me Shkupin dhe Tiranën në Këshillin e ardhshëm evropian më 28 dhe 29 qershor, në negociatat e vazhdueshme të pranimit me Malin e Zi dhe Serbinë të hapen kapituj të rinj, të miratohet liberalizimi i vizave për Kosovën dhe të shpërblehen përpjekjet për reforma të Bosnjës dhe Hercegovinës, varësisht nga rezultati dhe pasojat e zgjedhjeve të 7 tetorit. "E ardhmja e Ballkanit Perëndimor qëndron në Bashkimin Evropian, në sundimin e ligjit, demokracinë liberale, drejtësinë sociale dhe energjitë inovative të një shoqërie të hapur. Bisedimet e thella dhe ambicioze në rrugën e anëtarësimit në BE ofrojnë garancinë

më të fortë të mundshme që qytetarët e gjashtë vendeve në këtë të ardhme jo shumë të largët, të gëzojnë këto përfitime. Evropa nuk duhet të zhgënjë", thonë eurodeputetët në letërën e hapur drejtuar liderëve të BE-së.

## ZAEV LETËR TË HAPUR LIDERËVE TË BE-SË

Duke e nuhatur këtë gjendje dilamtike të disa shteteve të BE për hapjen e negociatave me Maqedoninë dhe Shqipërinë, Kryeministri i Zoran Zaev, të martën u ka dërguar letër të hapur liderëve të vendeve anëtare të BE-së, përmes së cilës ju bënë thirrje që të mbështesin nisjen e negociatave për Maqedoninë me BE-në. Zaev i njofton kryeministrat e vendeve anëtare të BE-së për marrëveshjen e arritur me Greqinë për Çështjen e Emrit, si dhe vendosjen e marrëdhënieve strategjike ndërmjet Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë. "Marrëveshja praqet mundësi historike për tejkalimin e kontestit 25 vjeçar, dhe ka penguar rrugën e Maqedonisë drejt integritimit Euro-Atlantike", shkruan Zoran Zaev. Ai në letër gjithashtu i njofton liderët edhe për hapat e radhës që duhet të ndërmerren që të sigurohet hyrja në fuqi e marrëveshjes dhe njofton ata se është bërë ratifikimi i marrëveshjes në Parlament, ndërsa të njëjtën gjë do ta bëjë edhe Greqia. "Që të sigurohet realizimi i marrëveshjes dhe dobite potenciale për të dy vendet dhe për rajonin e Evropës Juglindore si dhe për Evropën në përgjithësi, është e rëndësishme ndihma politike e vendeve anëtare të BE-së, për ta konfirmuar të ardhmen evropiane për vendin tim dhe për gjithë rajonin. Për këtë arsye kërkoj ndihmë për nisjen e negociatave me Republikën e Maqedonisë", shkruan Zaev në letër. Ai më tej shton se me vendimin për nisjen e negociatave do të jepet mirënjohje për procesin e reformave dhe do të lehtësohet edhe më tej procesi reformues. Ndryshe Zaev një ditë përpara si i

përket referendumin, tha se në rast se nuk do të jetë i suksesshëm ai do të japë dorëheqje. "Po, do të largohem nga pozita e kryeministrit, nëse nuk ka sukses referendumi. Por jam i sigurt se do të ketë sukses. Pres përqindje serioze 75-85%, në pajtueshmëri me atë se sa janë deklaruar qytetarët për anëtarësim në BE dhe NATO. Qytetarët nuk kanë çfarë të zgjedhin, nuk kanë alternativë tjetër. Ata vetëm duhet ta konfirmojnë se duan që Maqedonia të jetë anëtarësim në BE dhe NATO", tha Zoran Zaev. Temë kryesore krahas vendimit të BE për hapje ose jo të negociatave për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë, është mbajtja e Referendumit.

Më 16 korrik në Parlament do të sillet vendimi për nënshkrimin e referendumin për emrin. Ndërsa data në të cilën do të votojnë qytetarët do të kërkohet gjatë kohës pas miratimit të Ligjit për referendum. Vlen të theksohet se pas publikimit të vendimit për mbajtje të referendumin në Gazetën Zyrtare, nuk mund të kalojnë më pas se 60 ditë ose më shumë se 90 nga dita e mbajtjes së referendumin, përcjell Telegrafi Maqedoni. Burime nga Parlamenti thonë se data do të kërkohet në muajin shtator, në mënyrë që të arrihen afatet që dalin nga marrëveshja me Greqinë. Sipas nenit 30 të Ligjit – vendimet për referendum në nivel shtetëror konsiderohen të miratuara nëse votojnë shumica e numrit të përgjithshëm të qytetarëve që votuan, nëse votojnë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në listën zgjedhore. Ose që referendumi të jetë i suksesshëm duhet të dalin në votim 50 përqind plus një nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar, ndërsa do të vlejë vendimi që do të përkrahin 50 përqind plus një të qytetarëve që kanë votuar. Por pikërisht censusi prej 50 plus 1 përqind që të dalin në zgjedhje nga numri i përgjithshëm i votuesve.

## VMRO: MAQEDONIA NË KATASTROFË NACIONALE

Partia opozitare VMRO-DPM-NE përmes një komunikate me shkrim thekson se Maqedonia po ballafaqohet me katastrofë nacionale edhe në planin politik edhe në atë nacional për shkak të politikave antishtetërore të Zoran Zaevit. "Interesat më të larta nacionale janë të cënuara me marrëveshjen e kapitullimit me Greqinë, ndërsa në të njëjtën kohë kjo Qeveri shkatërruese shtetin dhe qytetarët po i shkatërron ekonomikisht. Ekonomia maqedonase është në fund për shkak politikave katastrofale të cilat po i udhëheqë karteli kriminel i Zoran Zaevit", thuhet mes tjerash në komunikatë. Nga kjo parti thonë se Republika e Maqedonisë për herë të parë shënon borxh publik prej mbi 5 miliard euro.

## KOXIAS: FILLIM TË NEGOCIATAVE DERI NË VERË TË VITIT 2019

Ministri grek i Punëve të Jashtme Nikos Koxias, tha se diskutimet në BE po udhëhiqen mes vendeve të cilat dëshirojnë fillim të negociatave me Maqedoninë deri në verën e vitit 2019 dhe ata të cilët dëshirojnë që kjo të jetë edhe më vonë.

"Sot diskutuam për zgjerimin e Bashkimit Evropian, ku ekzistuan dy linja të ndryshme. Nga njëra anë shumica prej 25 vendeve të cilët dëshirojnë dhe pranojnë të fillojnë negociatat deri në verën e vitit 2019 për Maqedoninë e Veriut, IRJM, dhe Shqipërinë dhe nga ana tjetër Danimarka, Franca dhe Holanda, të cilët dëshirojnë ta anulojnë atë. Në mënyrë shumë të qartë sqarova se politika gjeopolitike dhe gjeostrategjike në rajon kërkon ndihmë nga këto vende, e jo anulim. Sqarova se situata e brendshme në këto dy vende, kërkon stabilitet dhe siguri, e jo krijim të problemeve të reja. Në fund, gjendemi në një kompromis që do të parashikojë se mund të fillohet me hapjen e kapitujve deri në verën e 2019, respektivisht diçka që është shumë me rëndësi për neve, me komisionin aktual i cili shumë mirë i din edhe situatën edhe problemet", tha Koxias në Luksemburg.

Megjithatë, nuk përjashtohet asnjë variant në këtë moment: fillim i kushtëzuar i reformave, anulim i vendimit ose fillim i procesit të skriningut gjatë javëve ose muajve të ardhshme, që do t'u mundësonte francezëve t'ia "shesin" këtë vendim opinionit të tyre, i cili nuk është i njohur me finesat e proceseve negociuese në BE, ndërsa kapitujt të fillojnë të hapen më vonë.

Është më se e mundur që ministri të mos arrijë marrëveshje për Maqedoninë dhe çështja të transferohet te liderët e BE-së të enjten.

Nëse mbi 50 për qind e shtetasve të Maqedonisë votojnë pro marrëveshjes së Maqedonisë me Greqinë atëherë çdo institucion shtetëror detyrohen të respekton vullnetin e lirë të popullit

Shkup, 26 qershor – Kriteri i vetëm që Maqedonia të merr datë për fillimin e negociatave me BE- dhe ftesë për tu bërë anëtare i NATO-së aspak nuk është i rëndësishëm fakti se do ta nënshkruan apo jo presidenti i shtetit Ivanov ratifikimin e Marrëveshjes së nënshkruar midis Maqedonisë dhe Greqisë për mbylljen e kontestit për çështjen e emrit, por vendimtare do të jetë se si do shprehën qytetarët e Maqedonisë në referendumin që do të mbahet në fund të muajin shtator apo fillimin e muajit tetor të këtij viti si dhe çfarë do të shkruan në letrën që Greqia do t'i dërgon NATO aleancës apo Bashkimit Evropian. "Përveç integritetit në BE- dhe NATO, të gjitha alternativat tjera nuk janë të mira për Republikën e Maqedonisë. Gjithë shtete e vogla hyjnë në një bashkësi të shteteve të mëdha sepse nëse je shtet i vogël nuk mund edhe të ekzistosh", deklaroi Stevo Pendarovski koordinator për NATO në debatin "Aspektet pozitive dhe negative nga anëtarësimi i Maqedonisë në NATO", organizuar nga Instituti për Strategji dhe Zhvillim nga Shkupi.

"Le të presim letrën e vendit të vetëm anëtare e BE-së e cila deri më tani ka penguar anëtarësimin e Maqedonisë në BE- dhe NATO. Është shumë me rëndësishme se si do ta formulon letrën Ministria e Brendshme e Greqisë. Greqia ka premtuar se me nënshkrimin e marrëveshjes se do të jetë i pastër rekomandimi i tyre për anëtarësimin e Maqedonisë dhe se Greqia nuk do të bënë probleme jo vetëm për hyrjen e Maqedonisë në NAO por edhe në marrjen datës për

E ARDHMJA E MAQEDONISË NË BE DHE NATO

## ALTERNATIVAT TJERA JANË TË DËMSSHME



hapjen e bisedimeve me BE-në", deklaroi Pendarovski.

Ai gjithashtu potencoi se vullneti politik i qytetarëve të Maqedonisë është shumë më i fuqishëm për përkrahjen Qeverisë aktuale për referendumin edhe përkundër vullnetit politik të vetëm një partie opozitare e cila përmes shumë metodave gjegjësisht përmes organizimit të protestave të elektoratit të saj të përcjell mesazhe kërcënuese deri të pjesa më e madhe e maqedonasve dhe etniteteve tjera që janë pro mbylljes së kontestit të emrit me Greqinë dhe se tani Maqedoni është para dyerve të NATO-së dhe BE-së.

"Për herë të parë kjo Qeveri aktuale ka kohezioni më të fuqishëm për tu pranuar në BE- dhe NATO e sepse përveç shumë qytetarëve maqedonas që i jap përkrahje të fortë, përkrahjen e fortë e ka edhe nga numri më i madh i qytetarëve shqiptarë të cilët 90 për qind e tyre janë që Maqedonia të integrohet

në NATO dhe BE. "Është shumë e qartë se me hyrjen e Maqedonisë në NATO, definitivisht mbyllet të gjitha pyetjet se a do të bëhet Maqedonia", tha Pendarovski.

Duke folur për rëndësinë e referendumit ai potencoi se nëse mbi 50 për qind e shtetasve të Maqedonisë votojnë pro marrëveshjes së Maqedonisë me Greqinë atëherë çdo institucion shtetëror detyrohen të respekton vullnetin e lirë të popullit. "Mirëpo marrja e datës për fillimin e negociatave me BE-në dhe ftesa për NATO do të varet edhe nga ajo se si Maqedonia do të përmbushë tre kërkesat e marrëveshjes e ato janë nënshkrimi i ratifikimit të marrëveshjes dhe hyrje së saj në fuqi si dhe përmbajtja e letrës që Ministria e Punëve të Brendshme të Greqisë që duhet ta dërgon deri BE-ja dhe NATO se Greqia nuk pengon anëtarësimin e Maqedonisë në BE dhe NATO", deklaroi Stevo Pendarovski, koordinator për NATO nga Republika e Maqedonisë (Z.V.)



## Emërimi i ambasadorëve, Ivanovi pengesë

Shkup, 26 qershor - Këshilli Qendror i Klubit Diplomatik-Shkup duke diskutuar për çështjet e politikës së jashtme dhe diplomacinë e Maqedonisë, konstaton se ekziston pengesë në zhvillimin profesional të strukturës diplomatike si në Ministrinë e Jashtme ashtu edhe në prezantimin e vendit në jashtë kufijve.

"Është evidente se si rezultat i pengimit të emërimit të shefave të përfaqësive diplomatike të Maqedonisë në vendet e huaja nga ana e presidentit Gjorge Ivanov, në mënyrë jo të duhur, po mbrohen interesat e Maqedonisë. Kjo në veçanti është indikative kur duhet që në maksimum të angazhohet shteti që të finalizon integrimin e vendit në strukturat euro-atlantike", thuhet në kumtesën e Klubit Diplomatik-Shkup.

Por, në anën tjetër, kabineti i presidentit Gjorge Ivanov i demanton pretendimet të Klubit diplomatik në Shkup për bllokadë të shefave të emërtuar të përfaqësuesve diplomatikë dhe konsullorë të Maqedonisë. "Për të gjithë kandidatët e propozuar për ambasadorë, për të cilët më parë është arritur marrëveshje me Ministrinë e Punëve të Jashtme, procedurat për emërtimin e tyre janë në rrjedhë. Në përputhje me procedurat ligjore, për një pjesë të propozimeve të pranuar dhe të harmonizuara, procedurat për emërtimin e tyre kanë përfunduar dhe diplomatët tanimë janë dërguar për të kryer detyrën e ambasadorit", deklaroi Kabineti i Presidentit.

Nëse Klubi i diplomatëve, shtojnë ato, ka ndonjë vërejtje rreth procedurës për emërtimin e ambasadorëve, për përgjigje e drejtuam te Kabineti i ministrit të Punëve të Jashtme.

"Presidenti i Republikës së Maqedonisë, si më parë, mbetet në përputhje me angazhimet e tij për emërimin e kuadrove profesionale dhe ekspertë, të cilët do të kontribuojnë në përforcimin e rrjetit diplomatik dhe do t'i përfaqësojnë interesat e Republikës së Maqedonisë", citohet në kumtesë. Më parë, Klubi i diplomatëve - Shkup kishte bërë të ditur se të lira janë 20 pozita për ambasadorë të Maqedonisë jashtë vendit, për shkak, siç theksuan, mos emërimi i ambasadorëve nga ana e presidentit Ivanov pavarësisht nga një sërë propozimesh të cilat i ka dorëzuar Qeveria e RM-së.

"Me sjelljen e tillë të Ivanovit vjen në degradimin e nivelit të marrëdhënieve të Republikës së Maqedonisë me shtetet me të cilat kemi nënshkruar edhe marrëveshje për hapje të ambasadave me emërtimin e ambasadorëve. Gjithashtu nga kjo sjellje në mënyrë të drejtpërdrejt vuajnë pozita dhe reputacioni i Republikës së Maqedonisë para botës, të bllokuar mbeten iniciativat më të rëndësishme politike, ekonomike dhe kulturore për zhvillimin e marrëdhënieve të përgjithshme të subjekteve të interesuara dhe qytetar me partnerët e tyre në botë, ndërsa bllokohet dhe avancimi natyror dhe zhvillimi profesional i diplomatëve në Ministrinë e Punëve të Jashtme të RM-së", kumtoi Klubi diplomatik.

ZYRTARIZOHET QËNDRIMI I PRESIDENTIT

## Marrëveshja me Greqinë, pa aminin e Ivanovit

"Sa i takon vendimit të Ivanovit e njëjta ishte e pritshme, por nuk ndikon në hapat, apo implementimin e fazave të marrëveshjes. Qeveria greke veçmë ka dërguar letrat në BE dhe NATO", ka thënë zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski

Shkup, 26 qershor - Presidenti Gjorge Ivanov ka marrë vendim që të mos nënshkruaj Ligjin për ratifikim të Marrëveshjes me Greqinë dhe me këtë edhe të tejkalimit të dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit për Siguri të Kombeve të bashkuara, me qëllim ndalimin e përdorimit të Marrëveshjes së përkohshme që daton nga viti 1995.

Ivanov, siç informojnë nga kabineti i tij vendimin e tij për mos nënshkrimin e Ligjit për ratifikim të Marrëveshjes me Greqinë e ka dërguar deri tek të gjitha mediat në formë të shkruar, ku dhe janë dhënë arsyt pse presidenti nuk do të nënshkruaj asnjëherë këtë marrëveshje.

"Këtë vendim kam marrë për këto ar-

sy: Nuk kam mandat që të nënshkruaj Ligjin për ratifikim të Marrëveshjes me Greqinë. Një nga themelet kyçe të politikës sime gjatë programit tim të fushatës zgjedhore presidenciale gjatë vitit 2014 ka qenë se unë nuk pranoj ndryshim të Kushtetutës me qëllim ndryshimin e emrit të shtetit. Nuk pranoj ide dhe propozime që do të cenonin identitetin kombëtar maqedonas, veçantinë e kombit maqedonas, gjuhën maqedonase dhe modelin maqedonas të bashkëjetesës. Në zgjedhjet e fundit presidenciale 534.910 qytetar votuan për këtë politikë timen dhe më zgjedhën mua që të kryej funksionin e presidentit të shtetit", ka shkruar Ivanov në kumtesën dërguar mediave.

Pasi që presidenti Gjorge Ivanov e njoftoi Kuvendin se nuk do ta nënshkruajë dekretin e marrëveshjes me Greqinë, zëdhënësi i Qeverisë Mile Boshnjakovski tha se vendimi i tillë nuk do të ndikojë në implementimin e marrëveshjes.



"Sa i takon vendimit të Ivanovit e njëjta ishte e pritshme, por nuk ndikon në hapat, apo implementimin e fazave të marrëveshjes. Qeveria greke veçmë ka dërguar letrat në BE dhe NATO", ka thënë Boshnjakovski.

Gjorge Ivanov po punon në dëm të shtetit, kundër Maqedonisë dhe kundër të ardhmes së vendit, ka reaguar LSDM-ja, përmes një komunikate për media.

"Ivanovi nuk guxon të blloktojë të ardhmen e Maqedonisë. Në periudhën kur vendi është para shansit të marrjes së datës për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE dhe para shansit për marrjen e ftesës për në NATO, Ivanov vazhdon me politikat destruktive me çka i bën dëm shtetit dhe qytetarëve. Për të ardhmen nuk do të vendos Ivanovi destruktiv, por gjithë qytetarët", thonë në LSDM.

Krahas sjelljes së ulët të gardianëve, ekipi i MPN-së, ka mbledhur informacione se në burgun e Shutkës ekzistojnë indicie për korrupsion, posaçërisht kur bëhet fjalë për shitjen e celularëve dhe vendosjen personave në hapësira ky sinjali i rrjetit të telekomunikimit nuk është i bllokuar. Për këto arsye ato apelojnë që institucionet përkatëse t'i analizojnë dhe hetojnë rastet e tilla

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 26 qershor—Institucionet ndëshkuese përmirësues (IPN), vazhdojnë të mos i përmbushin standardet e nevojshme për risocializimin e të burgosurve dhe personave në paraburgim. Kjo situatë në masë të madhe mbizotëron në burgun e Shutkës, atë të Strumicës dhe në burgun e Kumanovës. Për gjendjen e rëndë e burgjeve së fundmi ka raportuar zyra e Avokatit të Popullit në Shkup, e cila përmes Mekanizmit Parandalues Nacional, ka vërtetuar se burgjet e apostrofuara edhe më tej kanë mungesë të theksuar në të gjitha sektorët.

"Serioze është mungesa e kuadrit profesional në këto INP. Gjendja aktuale ndikon në realizimin e papengesa të drejtave të personave që vuajnë dënime me burg, ndaj efekteve të risocializimit, ndaj të drejtës për sigurim shëndetësor, si dhe për realizimin e të drejtave të tjera gjatë kohës së vuajtjes së masës së paraburgimit", thuhet në raportin e fundit të MPN-së.

Vizitat e paparalajmëruara të MPN-së, gjatë 2017 në disa prej

INTEGRITETI I TË BURGOSURVE NUK RESPEKTOHET

# KAOSI NË BURGJE VAZHDON



## STACIONET POLICOR TË PANDRYSHUARA NDËR VITE

Pjesa dërmuese e stacioneve policor të vizituara së fundmi nga MPN-ja nuk i plotësojnë standardet e kërkuara ndërkombëtare. Analiza e zakonshme e Ombudsmanit për hapësirat për mbajtje në 13 stacione policor të Maqedonisë, ka konstatuar se 9 prej tyre aspak nuk i përmbushin kushtet e kërkuara. "Në stacionet policore në Kërçovë, Sveti Nikollë, Vallandovë, Makendoski Brod dhe Manastir kemi vërejtur se hapësirat për mbajtje janë në gjendje tejet të keqe, kështu që mbajtja në të njëjtat, vetvetiu paraqet trajtim nënçmues dhe johuman ndaj personave që mbahen. Kësisoj në stacioni policor të Aerodromit kemi konstatuar se përkundër vendimit

ministror që është ndaluar mbajtja e personave, gjatë njëres prej vizitave të paralajmëruara, ekipi i MPN-së ka konstatuar në persona që ishin të mbajtur për më tepër se 6 orë. Tutje gjendje kaotike në pjesën për mbajtje të personave ekziston edhe në stacionin policor të Draçevës. Por gjatë vizitës në këtë stacion hasëm në hapësira që krijojnë dyshime se aty mbahen personat e arrestuar", thuhet në raportin e MPN-së. Në pajtim me dispozitat e Ligjit për drejtësi ndaj fëmijëve, shumica e stacioneve policor të vizituara nuk kanë disponojnë më hapësirë për marrje në pyetje, me përjashtim të SP "Manastir" dhe SP "Strumicë".

burgjeve të Maqedonisë, njëkohësisht kanë konstatua se këto INP, vazhdojnë të përballen me mungesën e hapësirave të nevojshme për vendosje, lagështi e theksuar dhe mungesë e sistemit të ngrohjes e kështu me radhë. Me theks të veçantë me këtë situatë ballafaqohen personat që e vuajnë masën e paraburgimit në burgun e Shutkës në Shkup. Në drejtim të zgjidhjes së kësaj problematike

nga zyra e Avokatit të Popullit në Shkup, i bën apel Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve dhe drejtorisë së burgut të Shutkës, që urgjentisht t'i ndërmarrin masat për respektimin e dinjitetit dhe integritetit të personave që vuajnë masën e paraburgimit.

"Gjatë bisedave me personat e paraburgosur në burgun e Shutkës, ekipi i MPN-së është njofuar se shpesh herë ndodhë që

këto persona të ofendohen në bazë nacionale. Ky diskriminim më tepër ju bëhen pjesëtarëve të komunitet rom. Njëherit jo rrallë herë gardianët e burgut të Shutkës gjatë kohës së bastisjeve janë sjellur në mënyrë të ashpër, nënçmuese dhe arrogante me pjesëtarët e këtij komuniteti", theksojnë nga Ombudsmani.

Krahas sjelljes së ulët të gardianëve, ekipi i MPN-së, ka

mbledhur informacione se në burgun e Shutkës ekzistojnë indicie për korrupsion, posaçërisht kur bëhet fjalë për shitjen e celularëve dhe vendosjen personave në hapësira ky sinjali i rrjetit të telekomunikimit nuk është i bllokuar. Për këto arsye ato apelojnë që institucionet përkatëse t'i analizojnë dhe hetojnë rastet e tilla. Një situatë akoma më e keqe, gjithnjë duke u bazuar në të dhënat e Ombudsmanit, mbizotëron në burgun e Strumicës. Mungesa e seksionit për praninë, sipas ekipit të MPN-së, është arsye kryesore se pse personat e sapo dënuar vendosen në hapësirat për izolim të cilat janë në gjendje jashtëzakonisht të keqe. Ashtu si në shumicën e IPN, edhe në burgun e Strumicës mungojnë aktivitetet e sferës së arsimit, ndërkohë procesi i risocializimit reduktohet vetëm në biseda të kohëpaskohshme me personat e dënuar, në vend të trajtimeve individuale dhe kolektive. Ndonëse në fillim të këtij viti u paralajmëruar se do të përmirësohet sistemi shëndetësor në burgjet në vend, ai në burgun e Shutkës vazhdon të mbetet i njëjtë siç ka qenë. Cenimi i të drejtës së privatësisë po ashtu paraqet njëherë prej shkeljeve më të mëdha që ju bëhen të burgosurve në disa prej burgjeve të Maqedonisë. Banjat apo tualetet pa dyer, siç nënvizohet në raportin e radhës të Ombudsmanit, janë degradim klasik ndaj dinjitetit të të burgosurve, me çka të njëjtit detyrohet që kryerjen e nevojave fiziologjike ato t'i mbulojnë me batanije ose të gjinden në mënyrë tjetër.

## MINISTRI ADEMI NË BRUKSEL

# INTEGRIMI EVROPIAN I ARSIMIT — I DOMOSDOSHËM

"Qeveria e Maqedonisë është e vetëdijshme se alternativa më e mirë për përparimin shoqëror dhe ekonomik, krahas investimeve në arsim është edhe nevoja për investime në shkencë, hulumtime dhe inovacione", ka thënë ministri Arbër Ademi, në takimim e shtatë ministror në Bruksel. Integrimi i plotë i sistemeve tona arsimore në hapësirën evropiane të arsimit, sipas tij është i domosdoshëm

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 26 qershor—E krijuar që para gjashtë viteve në kuadër të programeve të Komisionit Evropian të Arsimit (KEA), Platforma e Arsimit dhe Trajnimit të Vendeve të Ballkanit Perëndimor vazhdon të jetë në fokusin e KEA-së, me qëllim të nxitjes dhe mbështetjes për bashkëpunim më të madh institucional mes vendet e rajonit, si dhe me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe shembujve pozitiv. Platforma në fjalë ka tubuar në Takimin e shtatë ministror, që nis punimet në Bruksel të martën dhe ku përveç;

tjerash synohet të detektohen sfida arsimore, si dhe të propozohen qasjet e përbashkët për tejkalimin e tyre. I pranishëm me këtë takim është edhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, i cili ka prezantuar pozicionet e Maqedonisë në raport me Platformën e Arsimit dhe Trajnimit të Vendeve të Ballkanit Perëndimor.

"Qeveria e Maqedonisë është e vetëdijshme se alternativa më e mirë për përparimin shoqëror dhe ekonomik, krahas investimeve në arsim është edhe nevoja për investime në shkencë, hulumtime dhe inovacione. Prandaj janë ndërmarrë

aktivitete të shumta dhe kanë nisur një sërë projektesh që në periudhën afatmesme dhe afatgjatë duhet të sigurojnë përparim në këto fusha", tha ministri Ademi gjatë panelit të diskutimit për sfidat arsimore të Ballkanit Perëndimor. Duke iu referuar ndryshimeve në Maqedoni, ministri Ademi është ndalur te Strategjinë Gjithëpërfshirëse Arsimore (SGJA) që kap periudhën e viteve 2018-2025. "Është një dokument strategjik i rëndësishëm që do të kontribuojë ndjeshëm në arritjen e qëllimit parësor të Qeverisë, e ky është integrimi i sistemit arsimor nacional në hapësirën evropiane të

arsimit", u shpreh ai. Ai, gjithashtu, ka potencuar se Strategjia në fjalë është përpiluar dhe do të zbatohet së bashku me të gjitha palët e interesuara. Kjo, sipas tij, paraqet garanci për zbatimin me efikasitet dhe efektivitet të SGJA-së. Integrimi i sistemeve tona arsimore me sistemin evropian të arsimit, sipas ministrit është i domosdoshëm. Lidhur me aktivitetet që dalin nga SGJA-ja, njeriu i parë i Arsimit dhe Shkencës në Maqedoni do të jap hollësi në panelin e diskutimeve që do të organizohen të mërkurën. Sipas programit të takimit, në datën 27 qershor janë paraparë panele diskutime ku-



shtuar sfidave dhe politikave për zhvillimin e arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Pjesëmarrës në këto takime janë edhe përfaqësuesit e lartë të Komisionit Evropian dhe të Drejtorisë së Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë, përfaqësues nga Drejtoria për Zgjerim, si dhe ministrat dhe përfaqësuesit e lartë të Ministrive të Arsimit të shteteve përkatëse: Maqedonisë, Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 26 qershor - Që nga zgjedhja e Naser Ajdari si gjykatës kushtetues nga 5 marsi këtij viti, injorimi, neglizhenca dhe mobingu klasik nga ana e udhëheqësisë njëqind për qind maqedonase të këtij institucioni ka vazhduar njëjtë siç kishte ndodhur para se te emërohej avokat shtetëror shqiptar. Procesi i filluar i avancimeve graduale stagnoi dhe çdo ditë nëpunësit shqiptar degradohen, pengohen në punë me imtësira banale dhe ushtrohet mbi ta mobing i llojit më të ulët sikur të ishin bonjak pa një tutor apo prind, ky është reagimi në formë të shkruar i nëpunësve shqiptar të Avokatit të shtetit drejtuar mediave. Siç shtojnë ata këto muajt e fundit egziston vakum kohor për zgjedhjen e avokatit të ri shtetëror të Republikës së Maqedonisë dhe avokat shtetëror të njësisë rajonale të Shkupit për të cilët pozicione plotësojnë kushtet dhe kriteret e nevojshme edhe ca nëpunës shqiptar te avokaturës shtetërore. "I gjithë ky mobing ushtrohet në stilin ,

edhe përkundrejt gjithë sjelljes, punës edhe raporteve korrekte që mundohen ti kenë nëpunësit shqiptar ne avokaturën shtetërore ndaj të gjithë nëpunësve në këtë institucion duke pasur parasysh peshën, rëndësinë dhe rolin e këtij institucioni në shtet", theksojnë nëpunësit shqiptar. Siç informojnë ata detyrën e avokatit shtetëror të Republikës së Maqedonisë deri më datë 5 mars 2018 e ushtronte Naser Ajdari nga Shkupi i cili ishte emëruar në këtë post nga nëntori i vitit 2013. "Duke parë gjendjen mizore të nëpunësve shqiptar në këtë institucion ai kishte ndërmarrë disa

## AVOKATI I SHTETIT PA PËRFAQËSIM ADEKUAT

## VETËM NJË SHQIPTAR

Nga 31 avokat të shtetit sa janë gjithsej në Maqedoni vetëm një është shqiptar në komunën e Gostivarit. Në Shkup janë dhjetë avokat shtetëror, por asnjë shqiptar



iniciativa që gradualisht nëpunësit shqiptar të arrinin avancimin e papërfillur nga ish avokatët maqedonas. Në këtë institucion Naser Ajdari arriti të shohë se ka nëpunës shqiptar me përvojë punë 12 vjeçare në të njëjtën pozitë si bashkëpunëtor më i ri, jurist me studime postdiplomike të mbaruara, me provim të jurisprudencës dhe me përvojë pune mbi 8 vite në të njëjtën pozitë si bashkëpunëtor më i ri, nëpunës me arsim të kryer të lartë dhe të punësuar si referent më i ri, me përvojë pune po ashtu disa vjeçare që përgjatë viteve kishin qenë të neglizhuar, të injoruar dhe të lënë anash tërësisht nga udhëheqësit e sektorëve dhe nga avokatët e shtetit të RM-së", thuhet në reagimin publik të nëpunësve shqiptar të Avokatit të shtetit.

Njëri nga ta që deshi të mbetet anonim tha për gazetën KOHA se nga 31 avokat të shtetit sa janë gjithsej në Maqedoni vetëm një është shqiptar edhe në komunën e

Gostivarit. "Në Tetovë dhe në qytetet tjera me shumicë shqiptare nuk ka avokat shtetëror shqiptar. Vetëm në Shkup i kemi dhjetë avokat shtetëror asnjë shqiptar. Avokatura shtetërore e Republikës së Maqedonisë numëron gjithsej 107 të punësuar ku prej tyre janë 82 maqedonas, 21 shqiptar, 2 boshnjak, 2 serb dhe 1 turk, ku te gjithë 21 shqiptarët gëzojnë titullin referent i ri dhe bashkëpunëtor i ri edhe përkaj përvojës mbi 10 vjeçare në këtë institucion. Duam të alarmojmë opinion se momentalisht gjendja është e mjerueshme dhe ti bëjmë apel Qeverisë sidomos partive shqiptare në pushtet që të ndërveojnë menjëherë duke zgjedhur drejtor të ri, dhe të avancojë shqiptarët këtu sepse e kane dhe obligim ligjor më Marrëveshje e Ohrit", thonë kështu nëpunësit shqiptar në këtë institucion. Por sa i përket mobingut ushtruesi i detyrës së avokatit të shtetit Sasha Jançevski për gazetën KOHA përjashtoi çdo

mundësi që u bëhet nëpunësve shqiptar. "Nuk di ndonjë rast konkret të sjelljeve jo të mira të maqedonasve ndaj shqiptarëve. deri tek unë nuk është shprehur ndonjë pakënaqësi. Unë për vetë edhe shqip ju flas sepse e di nga pak dhe nuk kam vërejtur se ndonjëri prej tyre është i pakënaqur me neve", thotë Sasha Jançevski.

Nga ana tjetër ai insistoi të di se prej kur nëpunësit shqiptar janë ankuar dhe se kush janë prej tyre. Sa i përket avancimeve Sasha Jançevski tha se janë të vërteta ato çka ane thënë nëpunësit shqiptar se ka vetë referent të ri dhe bashkëpunëtor të ri. "Unë më herët kam qenë zëvendës i Naser Ajdarit dhe është ë vërtetë se ai ka bërë kërkesa për avancim dhe nuk janë përfillur. Me përgjegjësi e them se edhe unë që tani ushtroj këtë post do të bëjë të njëjtën do të insistoj që të avancohen disa nëpunës që mendoj se i plotësojnë kushtet ligjore", tha Sasha Jançevski.

## NJOFTIM I INSTITUTIT TË SHËNDETËSISË PUBLIKE

## Fruthi vjen nga pushuesit në vende të huaja

Simptomat themelore që shfaqin sëmundjen janë kollitja, ethet, skuqjet e lëkurës, diarre dhe të vjella. Një gjendje më e rëndë klinike ndodh kryesisht tek të rriturit

Koha

Delvina KËRLUKU



Shkup, 26 qershor - Shumë qytetarë të Maqedonisë që kanë kaluar pushimet verore, këtë vit, në vendet bregdetare janë prekur nga epidemia e fruthit, njofton Instituti i shëndetësisë publik (ISHP). Prandaj, nga ky institut paralajmërojnë që qytetarët e vendit të mos udhëtojnë të pambrojtur, deri në përfundimin e sezonit veror. Sipas ISHP, aktualisht ekziston epidemia e fruthit në Greqi, Serbi, Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Itali, Francë, Spanjë, Portugali dhe vende të tjera evropiane. Janë këto vende ku qytetarët e Maqedonisë shpesh shkojnë për pushime verore. Nga ISHP rekomandojnë që të gjithë qytetarët, të cilët udhëtojnë të kon-

trollojnë kartën e tyre të vaksinimit dhe të dhënat e vaksinimit për fëmijët e tyre. Të sigurohen nëse fëmijët janë të vaksinuar plotësisht, në përputhje me kalendarin të imunizimit të Maqedonisë, duke përfshirë edhe dy doza të vaksinës kundër fruthit, kjo nënkupton sipas moshës që ka individit. Dr. Largime Jusufi Ballazhi nga Instituti i Shëndetit Publik thotë për gazetën "Koha", që janë hospitalizuar, në qershor, një çift nga Dibra, për në Ohër, pastaj në Klinikën Universitare në Shkup, ku edhe kanë qenë në pushim në Shqipëri dhe kur janë kthyer të sëmurë, kanë infektuar edhe prindërit e tyre. Doktoresha Ballazhi thotë se mos vak-

sinimi shkakton prekjën nga epidemia dhe se njerëzit që nuk vaksinohen është si rezultat i antikampanjave që ndikon shumë në uljen e vaksinimit nga morbili. Ajo apelon që të gjithë fëmijët duke mos përjashtuar edhe të rriturit të vaksinohen kundër morbililit si e vetmja mënyrë preventive që të ndalojë epideminë.

Nga 20 mars deri më 20 qershor të këtij viti, në vend janë konfirmuar tri raste të reja të fruthit, në gjithsej 14 raste të regjistruara në 2018. Një person me simptoma të fruthit raportohet në muajin maj. Është një banor i Sarajit, në moshën 38 vjeçare. Pacienti u shtrua në spital në Klinikën për Së-

mundje Infektive dhe korespondon se nuk ishte vaksinuar më parë me vakcina kundër fruthit. Supozohet se ai është infektuar në Novi Pazar, Serbi, ku më parë ka udhëtuar. Dhe dy persona nga Dibra.

Epidemia, e cila filloi në tetor të vitit të kaluar filloi nga Kosova, vazhdoi në Serbi dhe Mal të Zi, duke sjellë rreth 5.000 raste të kësaj sëmundje infektive dhe dhjetëra vdekjeve në rajon. Sëmundja zakonisht ndodh tek fëmijët e vegjël, por nuk përjashtohet edhe te të moshuarit. Fruthi transmetohet lehtësisht prej njeriut tek njeriu përmes pështymës, gjatë të folurit ose përmes teshtitjes. Simptomat themelore që shfaqin sëmundjen janë kollitja, ethet, skuqjet e lëkurës, diarre dhe të vjella. Një gjendje më e rëndë klinike ndodh kryesisht tek të rriturit. Ata gjithashtu mund të marrin bronkopneumoni si një ndërlikim të fruthit. Epidemiologët bëjnë thirrje që turistët para se të shkojnë me pushime, të marrin informacion rreth destinacionit ku ata qëndrojnë.

## Mbledhje komemorative kushtuar Vullnet Palloshit

Tetovë, 26 qershor - Në Universitetin e Tetovës, familjarë, miq, shokë, kolegë, në një mbledhje komemorative kanë kujtuar jetën dhe veprën e profesorit tanimë të ndjerë Vullnet Palloshit me ç'rast edhe një herë është folur për figurën, jetën dhe veprën e tij. Dekani i fakultetit të shkencave të zbatuara Nderim Zeqiri theksoi se Profesor Vullnet Palloshi në vazhdimësi ka dhënë një kontribut të çmuar në Universitetin e Tetovës pranë Fakultetit të Shkencave të zbatuara veçanërisht në drejtimin e infrastrukturës, kontributi i tij zgjerohet edhe jashtë kornizave të Universitetit të Tetovës pasi që Profesor Palloshi ka qenë pjesë e projekteve dhe konferencave të ndryshme kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Veprimtaria e gjerë e pasur dhe shumë rrezatuese e profesor Vullnet Palloshit do të kujtohet për shumë gjatë nënvizoi profesor Abdyl Koleci. Të pranishmit në këtë mbledhje komemorative në emër të familjes Vjosa Palloshi i përshëndeti dhe falënderoi për respektin që kanë treguar për profesorin e ndërë Vullnet Palloshi u nda nga jeta më 18 qershor. Ai ishte një personalitet i shquar ndër shqiptarët në Maqedoni dhe në nivel kombëtar, i cili në fushën e tij profesionale, inxhinierinë e rrugëve dhe infrastrukturën rrugore, ka dhënë kontribut shumë të çmuar, jo vetëm si ekspert i kësaj fushe, por edhe si punonjës shkencor, ligjërues fakulteti i lëndëve nga kjo fushë dhe si udhëheqës i disa institucioneve në nivel shtetëror dhe i asociacioneve profesionale. (U.H)

## Filipçe: Do të rinovohet Klinika për Kirurgjinë Digjестive

Shkup, 26 qershor - Në javët e ardhshme, Klinika për Kirurgjinë Digjестive do të rinovohet, ka paralajmëruar mnisistri i shëndetësisë, Venko Filipçe. Sipas tij, disa nga pacientët do të transferohen në "8 Shtator" dhe në Spitalin e Qytetit "Shën Naum Ohridski". Ndërsa, për momentin "8 Shtatori" ka 6 respiratorë në dhomën e shokut dhe 2 respiratorë rezervë që përdoren. Për shkak të frekuencës së lartë të pacientëve, do të sigurohen kushte për pikat shtesë të kujdesit intensiv me 2 respiratorë shtesë, të cilët do të përdoren në periudhën e ardhshme, deri në përfundimin e renovimit të kirurgjisë abdominale. D.K.

# Prapavija e incidentit në Haraçinë

Shkup, 26 qershor-Një incident mes policisë dhe dy personave të kërkuar për vuajtje të dënimit me burg të hënën është regjistruar në Haraçinë. Raporti zyrtar i MPB-së, thotë se ngjarja është regjistruar të hënën rreth orës 17:00, në rrugën 1 të kësaj komune periferike të Shkupit. "Dy zyrtarë të policisë kanë ndaluar një makinë të tipit 'Golf' në të cilin ndodheshin dy persona O.M (33) dhe G.M (20), të cilët kërkohen me flet arrest për mbajtjen e dënimit me burg", thonë nga SPB-Shkup. Në përshkrimin e ratit nga MPB-ja, njoftojnë se gjatë momenteve kur policia po ndalonte makinën, drejtuesi O.M. ka nisur makinën 'Golf' nga prapa dhe ka goditur policin.



shtënë me armë në ajër si shenjë paralajmërimi, po drejtuesi i makinës nuk kishte ndaluar dhe më këtë ai kishte goditur policin tjetër, ku edhe ishte arratisur nga vendi i ngjarjes", theksojnë nga policia e Shkupit.

Incidenti i ditës së hënë në Haraçinë, ku pjesëtar e njëstit "Alfa" në ajër kanë shtënë tre plumba, për banorët e kësaj komune nuk është veprim profesional dhe të njëjtit potencojnë se policia ka shtënë në drejtim të veturës dhe jo në ajër, siç thuhet në kumtesën zyrtare.

Pas këtij incidenti incidentit që ndodhi pasditen e 25 qershorit në Haraçinë, ku policia ka shtënë me armë në drejtim të një makine e cila dyshohej së është drejtuar nga dy persona të kërkuar me flet arrest, ka reaguari kryetarja e kësaj komune, Milikije Halimi. Përmes një statusi në rrjetin social fejsbuk ajo ka kërkuar nga policia të ketë sjellje të kujdesshme në zona të banuara. "Urojmë që rasti në Haraçinë të sqarohet sa më shpejtë nga organet e rendit. Ne si komunë, nuk e arsyetojmë përdorimin e armëve në ambiente publike", ka shkruar kryetarja e Komunës së Haraçinës, Milikije Halimi. Ndryshe nga MPB-ja, kanë potencuar se janë ndërmarrë të gjitha masat për zbardhjen e rastit dhe arrestimin e personave të kërkuar.

## Rrihen tre persona në Tetovë

Tetovë, 26 qershor-Tridhjetë e tetë vjeçarja Z.T. nga Tetova, të hënën në orën 19 e 30 minuta, bashkë me dhëndrin e saj me iniciale D.B. 24-vjeç, dhe vajzën e saj, kanë qenë të sulmuar fizikisht, përpara pallatit ku jetojnë në rrugën „Vëllezrit Miladinovi“, në Tetovë. Pas një zënke të shkurtër verbale, ata i ka sulmuar fqinji i tyre 22-vjeçari me iniciale S.A., bashkë me 27-vjeçarin E.A. dhe 44-vjeçarin D.A. që të gjithë nga Tetova, të cilët gjatë sulmit kanë përdorur grushta, shufra metalike, shkop druri dhe mjete tjetër forta, dhe për tu mbrojtur i sulmuari D.B. ka marur një sharrë motorike, ku ka qenë i sulmuar me shufër hekuri në kokë. Tre personat e sulmuar, kanë marë lëndime të dukshme trupore, të cilat janë fotodokumentuar. Diku më vonë, nga të involvuarit në këtë rast, të cilët vetë janë paraqitur në Stacionin policor Tetovë, me vërtetim janë marur shufra metalike, dhe shara motorike. Meren të gjitha masat dhe aktivitetet për zbardhjen e plotë të rastit, dhe të gjitha detajet lidhur me këtë rast, ku edhe do të pasojnë padi adekuate njofton policia e Tetovës.

## Lëndohet një fëmijë në Kumanovë

Të martën, në ora 09:50 në rrugën "11 Tetori" në Kumanovë, mbi xhaminë e qytetit, ka ndodhur një aksident trafiku, ku janë përfshirë një automjet udhëtarësh "Fiat Linea" pronë e MPB-së së RM, i drejtuar nga P.S. (44) i punësuar në MPB të RM-së dhe një djalë shtatëvjeçar, informoi sot SPB Kumanovë. Pas aksidentit fëmija është dërguar në spitalin e Kumanovës prej ku, pas një verifikimi të kryer mjekësor, i janë konstatuar lëndime të rënda trupore, pas së cilës është dërguar në kompleksin e klinikave "Nëna Terezë" në Shkup. Lidhur me ngjarjen, Prokurori publik dhe SPB Kumanovë ndërmori masa për vërtetimin e rrethanave dhe pastrimin e rastit. Gjithashtu, për ngjarjen është informuar edhe sektori për kontroll të brendshëm, hetime kriminale dhe standarde profesionale.

## Shkup, 13 aksidente trafiku

Në Shkup e rrethinë gjatë 24 orëve të kaluara janë regjistruar 13 aksidente. Në gjashtë aksidente janë lënduar gjashtë persona, prej të cilëve njëri më rëndë.

Dëmi material është shkaktuar në shtatë aksidente.

Nga MPB informojnë se policia e rrugës ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh kundërvajtjesh.

Gjithsej 107 shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar me shenjë komunikacioni, shtatë shoferë kanë qenë nën ndikimin e alkoolit, 12 e kanë



drejtuar makinën me patentë të skaduar, ndërsa 12 me automjete të paregjistruara, katër janë rreshtuar në mënyrë jo të drejtë, ndërsa një shofer nuk u ka lënë përparësi kali-

mi këmbësorëve në vendkalim të shënuar për këmbësorë.

Në mënyrë të padrejtë janë parkuar 242 automjete, ndërsa 51 janë larguar nga merrimanga.

## Në Gjermani kosovari vret gruan me sëpatë

Një person kishte vlarë bashkëshorten e tij me 39 goditje me sëpatë dhe tani është dërguar në një spital psikiatrik. Vendosi e tij në psikiatri e ka urdhëruar Gjykatën rajonale e Bonit, bëjnë të ditur gjatë ditës së hënë mediat gjermane. 37-vjeçari nga Kosova ka qenë në një gjendje "çmendurie" kur e kreu krimin ndaj gruas së tij 28-vjeçare. Pasi që ai e kreu krimin në një gjendje të paafetësisë për tu dënuar, ai nuk ka mundur të akuzohej për vrasje.

Gruaja në Gjermani kishte

ardhur vetëm gjashtë javë më parë nga Kosova. Bashkëshorti i saj, i cili jetonte në Siegburg dhe punonte në një kuzhinë hoteliere, ishte shumë i bindur se bashkëshortja e tij mësuese e donte një person tjetër.

Në këtë proces ai i deklaroi si provë takime dhe diskutimet e të ndjerës, por të cilat, sipas Gjykatës nuk kanë ekzistuar kurrë. I pandehuri kishte dëshmuar se ai ishte tallur dhe provokuar nga gruaja e tij, natën e 1 tetorit 2017, shkruajnë mediat gjermane, përcjell Albinfo.ch. Ai kishte marrë një sëpatë



dhe e ka goditur bashkëshorten në kokë dhe në qafë. Gruaja u mbulua me gjak dhe ndërroi jetë.

Kosovari ka vuajtur përkohësisht nga një ngacmim postraumatik, si refugjat i luftës. Gjendja e tij është diagnostifikuar 13 vite më parë dhe ishte trajtuar me barëra.

## Shqiptari rreh gruan, qëllon me armë të birin

Një 57-vjeçar shqiptar ka përfunduar në prangat e policisë në Carsoli të Italisë, pasi dhunoi bashkëshorten dhe tentoi të qëllonte me armë të birin. Sipas mediave fqinje, ngjarja ndodhi në banesën e çiftit shqiptar gjatë orëve të natës.

Pas një zënke që duket se lindi për shkak të xhelozisë, shqiptari qëlloi me armë djalin 20-vjeçar, fatmirësisht pa e prekur. Alarmi u dhua nga bashkëshortja e tij, e cila njoftoi autoritetet policore.



44-vjeçarja mësohet se dhunoi vazhdimisht nga bashkëshorti. Kur mbërritën në banesën e

çiftit në Villa Romana, karabinierët e gjetën shqiptarin e identifikuar vetëm me iniciale V.F. në gjendje

të rënduar pasi kishte konsumuar alkool.

Gjatë kontrollit, përveç armës së përdorur në drejtim të të birit, ata gjetën edhe 5 pistoleta të tjera, 2 prej të cilave të modifikuara, disa karikatorë, si dhe rreth 70 fishekë të kalibrit të ndryshëm, shkruan "Klan". 57-vjeçari, i cili në të shkuarën ishte denoncuar për keqtrajtim në familje dhe mbajtje abuzive të armëve, tashmë akuzohet për tentativë vrasjeje në dëm të djalit të tij, armëmbajtje pa leje etj.

## Policia, respektoni rregullat e komunikacionit

Tetovë, 26 qershor-Në fillim të muajit të ardhshëm, në rajonin më të gjërë të Pollogut, pritet të filloj ardhja e Gurbetqreve, që janë me punë të përkohëshme jashtë vendit, të cilët një pjesë nga pushimi i tyre verorë, tradicionalisht e kalojnë në vendlindjen e tyre. Për shkak të kësaj, edhe më shumë do të intensifikohet, gjegjësisht do të rritet frekuentimi i përgjithshëm në rrugët dhe nëpër lagjet e Tetovës dhe të Gostivarit. Sektori për Punë të Brendëshme Tetovë, edhe një herë apelon deri te vozitësit, të respektojnë rregullat dhe dispozitat ligjore në trafik, dhe të përshtratin shpejtësinë sipas kushteve të rrugës, të mos i parkojnë veturat e tyre vend e pa vend, të mos ulen para timonit nën gjandje të alkoolizuar, të lodhur, dhe pa mos e kontrolluar gjendjen teknike të veturave, të mos parakalojnë në mënyrë të paregullt, dhe veçanërisht të kenë kujdes ndaj këmbësorëve dhe biçikletistëve. Këshillohen vozitësit që me seriozitet të lartë të marin këto apele dhe paralajmërimet, të Sektorit për punë të brendëshme Tetovë, dhe në të ardhmen tu përmbahen rregullave, si dhe urdhrave që japin pjestarët e policisë. Kjo për shkak se më së shumti, vetëm se me hov të plotë, janë duke u ndërmarrë aktivitete dhe kontrolla preventive në rajon, të cilat do të vazhdojnë edhe gjatë dy muajve të ardhshëm.





Kanadaja ofron të ardhura prej 80.000 dollarë kanadezë (rreth 51.457 euro) në vit, por edhe përkundër kësaj oferte, ata kanë hasur në vështirësi për të gjetur shoferë kamioni, ku si shkak theksohen kushtet e vështira të punës

# KANADAJA KËRKON 48 MIJË SHOFERË KAMIONI



Shoqata e shoferëve të kamionëve në Kanada njofton se sektori të transportit i mungojnë 48.000 shoferë anembanë vendit dhe se kjo zbrastirë duhet të plotësohet deri në vitin 2024.

Shumë kompani të transportit të New Brunswick-ut që merren me transport ankohen për kushtet e vështira të jetesës dhe punës, për çka edhe nuk mund të gjejnë shoferë që do të udhëtojnë në distanca të gjata. Të ardhurat që rriten dita ditës siç duket nuk janë zgjidhje e problemit. Shoferët e kamionëve që sapo fillojnë të merren me këtë punë çdo vit fitojnë rreth 80.000 dollarë kanadezë (rreth 51.457 euro). Në disa pjesë të ardhurat mund të arrijnë deri në 100.000 dollarë kanadezë (rreth 64.361 euro) në vit.

Autoritetet e New Brunswick-ut, të cilëve gjithashtu një kërkesë u dorëzoi edhe Shoqata e shoferëve të kamionëve në provincat e Atlantikut, kanë nisur një program për emigrantët shoferë të ka-

mionëve. Kështu, në periudhën midis 2015 dhe 2017, u punësuan 390 shoferë kamioni me origjinë nga vendet e huaja. Në kuadër të pilot projektit janë punësuar shoferë nga Britania e Madhe, Bullgaria, Polonia, Ukraina dhe Republika e Afrikës së Jugut.

Robert Trites, i cili punon në projekt, tha se problemi më i madh me të cilin ballafaqohen është se shoferët, pas marrjes së leje qëndrimit, shkojnë në Ontario ose në provincat perëndimore.


Trites tha se shoferët kryesisht punojnë 10-12 ditë pa ndërprerje, pas së cilës pushojnë për 3 deri në

4 ditë. "Nga aspekti i kushteve, vërtetë nuk është një industri tërheqëse. Njerëzit nuk duan aq gjatë të jenë larg shtëpive", tha Trites.

Al Whittaker, i cili posedon një kompani në New Brunswick, tha se për 30 vite merret me transport dhe me vështirësi gjejnë punëtorë të rinj. "Shoferi ynë më i mirë është 74 vjeç dhe çdo javë plotëson orët maksimale të punës. Një tjetër shofer është 72 vjeç dhe tjetri 64 vjeç. Vetëm son-te kemi 81 dërgesa dhe nuk kemi shofer", tha ai. John Beaudry, themeluesi i Qendrës së transportit të Kanadasë, tha se pagat e sho-

ferëve rriten çdo vit me rreth 10 për qind. Ai potencoi se shoferët në distanca të gjata që në vitin e parë fitojnë 100.000 dollarë kanadezë, por që, pavarësisht kësaj, nuk ka shoferë të mjaftueshëm. "Kamionët qëndrojnë në parking", ankohet ai. Puna e shoferit të kamionit, thotë ai, fillimisht është tërheqëse për të rinjtë dhe personat e vetmuar, sepse fitojnë shumë dhe kanë mundësi të shohin vende të ndryshme.

"Megjithatë, kushtet bëhen gjithnjë e më të vështira me kalimin e kohës pasi të krijohet familje", shtoi Beaudry. (AA)



## Maqedonia me indeksin më të ulët të çmimeve në Evropë

Maqedonia është vendi me indeksin më të ulët të çmimeve në Evropë, ndërsa Islanda me nivelin më të lartë, transmeton AA.

Instituti i Statistikave të Turqisë (TUIK) shpalsi rezultatet e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB) për vitin e kaluar sipas indeksit të nivelit të çmimeve për shpenzimet e konsumit familjar.

Në rezultate janë përfshirë 28 shteteve të Bashkimit Evropian (BE), 3 shteteve të Shoqatës Evropiane për Tregti të Lirë (EFTA) (Zvicra, Islanda dhe Norvegjia), shtete kandidatë (Turqia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) si dhe një shtet kandidat potencial. Hulumtimi i zbatuar në 37 vende tregon se me indeksin më të ulët të çmimeve prej 47 është Maqedonia, ndërsa me indeksin më lartë prej 166 është Islanda.

Indeksi i nivelit të çmimeve tregon fuqinë blerëse të valutave kombëtare të vendeve në krahasim me kursin e këmbimit. Në rast se indeksi i nivelit të çmimeve të një vendi është mbi 100 atëherë ky vend konsiderohet si i "shtrënjtë" në mesataren e vendeve me të cilat krahasohet, ndërsa nëse është më e ulët se 100 atëherë konsiderohet si i "lirë".

## Pasiguria e Brexit-it rrezikon 860 mijë vende pune

Industria e makinave ka paralajmëruar kryeministren britanike, Theresa May se nuk ka dividend "Brexit" për biznesin, sakaq 860,000 vende punë po vihen në rrezik, veç nëse qeveria "rimorkon" linjat e saj të kuqe në negociata.

BMW do të mbyllë vendet e punës pranë Britanisë së Madhe, nëse vonesat e doganave mund të çenojnë furnizimin pas Brexit.

Një paralajmërim nga një sektor i vetëm i biznesit, lobi i makinave i ka thënë qeverisë se ajo ka nevojë minimalisht të mbetet në bashkësinë doganore dhe një marrëveshje që sjell "përfitim të tregut të vetëm". "Nuk ka dividend të Brexit për industrinë tonë," tha Michael Hawes, shef

ekzekutiv i Shoqatës së Prodhuesve të Makinave dhe Tregtarëve, shkruan The Guardian. Ai tha se pasiguria e Brexit ishte duke penguar investimet dhe thirrjet e përsëritura për Mbretërinë e Bashkuar për të qëndruar në partneritetin doganor, derisa qeveria të dilte me një "plan të besueshëm B". Me ngadalësimin e investimeve dhe me kalimin e kohës, negociatorët duhet të vazhdojnë punën për të rënë dakord për një marrëveshje që do t'i japë fund pasigurisë dhe t'i japë përparësi nevojave të sektorit të automobilave, tha SMMT. Sektori ishte rritur për të tetën vit radhazi, me një qarkullim prej 82 miliardë dollarësh në vitin 2017. Megjithatë, thuhet se 2018 ka treguar



një ngadalësim të prodhimit, me investime të dedikuara për modele të reja, pajisje. Investimet janë përgjysmuar në rreth 347 milionë funte. /Monitor



## Lançohet tenderi për ndërtimin e termocentralit në Kosovë

miliardë dollarë).

Ky do të jetë investimi më i madh energjetik në gati tre dekada në Kosovë që lufton me mungesë të energjisë. Rreth 90 për qind e energjisë elektrike në vend prodhohet në dy termocentrale të vjetra me qymyr, që janë ndërndotësit më të mëdhenj të Evropës.

"Procesi i përzgjedhjes përbehet nga një tender ndërkombëtar konkurrues prej dy fazave, sipas Rregullorës së Prokurimit të Bankës Botërore", thotë ContourGlobal në një deklaratë të dërguar në postën e Reuters, transmeton

lajmi.net.

"Ai përbëhet nga një proces fillestar përzgjedhës, i pasuar nga kërkesat për propozime", thotë kompania, duke shtuar se afati për aplikim përzgjedhjen fillestare është 2 gusht.

Banka Botërore tha javën e kaluar se ende nuk ka vendosur nëse do të mbështesë projektin.

Qeveria e Kosovës i kishte kërkuar huadhënësit më parë që të ofronin garancitë ndaj rrezikut për projektin që do të mundësonte kredi më të lira për ndërtim të termocentralit.

Kosova ka më shumë se 14 mi-

liardë ton rezerva të provuara të linjtit, e pesta më e madhe në botë.

Nëse Banka Botërore nuk jep mbështetjen e saj, mbetet e paqartë se si do të vazhdojë projekti.

Qeveria më parë tha se projekti pritej të ndihmojë në rritjen ekonomike të Kosovës në 5 ose 6 për qind në vitet e ardhshme, nga 3.7 për qind në vitin 2017.

Ambjentalistët janë ankuar se termocentrali mund ta mbyllë Kosovën në një të ardhme të mundësuar nga linjiti – e cila është forma më e ndyrë e qymyrit.

Por, ContourGlobal ka thënë se

termocentrali i ri do të përmirësojë cilësinë e ajrit, duke i reduktuar lëshimet nga dy termocentralët që aktualisht e ndotin zonën, njëri prej të cilëve do të mbyllet.

"Emetimet e pluhurit do të reduktohen me 93 për qind, ndërsa oksidet e squfurit dhe oksidet e azotit do të reduktohen me 84 për qind dhe 93 për qind, ndërkohë që dioksidi i karbonit do të ulet me 37 për qind", thotë ContourGlobal.

Kompania gjithashtu tha se shpreson të sigurojë një partner të kapitalit neto deri në fund të vitit ose në fillim të vitit 2019. /ZËRI.INFO/

# BRAVO, KRYEMINISTËR!

Nga  
Agim Vinca



U takuam në Panairin e Librit. Unë hyja, ti dilje. Unë vetëm, i shoqëruar nga një ish-student imi, ti i rrethuar nga shpura jote prej këshilltarësh e bodi-gardësh.

Nuk isha zatetur me ty kështu ballë për ballë nga koha kur u bëre kryeministër. Kur u ndale, mendova se dëshiron të më përshëndesësh, por isha mashtruar.

"Agim - më the; as 'profesor', as 'zoti Vinca', por Agim, me emër, si t'i kishim ruajtur lopët bashkë - ti je mendje e ndritur, por kur të shkruajsh për politikë thellohu pak se nuk i merr vesh punët e politikës!"

Më erdhën gand këto fjalë, më goditën si rrufe nga qielli i kaltër, si thuhet.

Shihej se ishe zemëruar me mua dhe se mezi kishe pritur rastin të ma shfaqje zemërimin, madje pa e zgjedhur kohën as vendin.

A thua cili shkrim imi e paska hidhëruar kaq shumë Kryeministrin? mendova shpejt e shpejt në hapësirën e ngushtë mes stendave me libra, ku vazhdimisht kalonin njerëz, vizitorë të Panairit.

Duhet të jetë intervista në Kosova-Press, sepse nuk di ndonjë shkrim tjetër të kohëve të fundit, ku të kem folur për qeverinë Haradinaj.

Më luti disa ditë një ish-student imi, i punësuar rishtas në këtë agjenci lajmesh për një intervistë. Më erdhi keq ta refuzoja dhe pranova.

Më pyeti për shumë çështje: për gjendjen e arsimit, për pozitën e librit, për qëndrimin tonë ndaj gjuhës, për krijuesit tanë të rinj dhe Akademinë tonë plakë dhe, natyrisht, edhe për Qeverinë.

Pyetjes së gazetarit të Kosova-Press-it se a do të ketë zgjedhje të parakohshme, iu përgjigja afërsisht kësaj: "Nuk besoj se kjo qeveri do ta çojë mandatin deri në fund. Për mua kjo qeveri e ka humbur besueshmërinë ditën që ia rriti rrogën vetes 100% e më shumë".

Idenë time redaksia e kishte përmbledhur me fjalët e vëna si moto në krye të intervistës. "Për profesorin universitar dhe studiuesin e letërsisë, Agim Vinca, Qeveria e Kosovës është jetëshkurtër dhe vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme për ta ndryshuar gjendjen në të cilën aktualisht është Kosova".

Këto janë duket fjalët që të paskan zemëruar aq shumë, zoti Kryeministër, sa të shtynë të më sulesh me fjalët: "Je mendje e ndritur, por nuk merr vesh nga politika!"

(Politikë e madhe kjo e Ramushit!

E madhe dhe vizionare! Si e Çerçillit, e Dë Golit, e Adenauerit gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, apo e Klintonit dhe Toni Blerit në kohën tonë, ndonëse këta të fundit ishin "të majtë", ndërsa Ramushi e Hashimi janë "të djathtë"!)

Nga politika ndoshta s'marr vesh shumë, nuk pretendoj se i njoh mirë qokat dhe dredhitë e saj, por e di, e shoh me sy dhe e preki me dorë realitetin në të cilin jetoj; gjendjen katastrofike ekonomike, sociale, morale dhe politike nëpër të cilën po kalojmë si shoqëri.

Nuk jam njeri që merrem me politikë për të përfitur prej saj si ju politikanët tanë, me ndonjë përjashtim të rrallë, por si intelektual nuk mund të jem indiferent ndaj zhvillimeve politike në vendin ku jetoj dhe në mbarë hapësirën shqiptare.

Ajo që thashë për ty dhe qeverinë tënde në intervistën e Kosova-Press-it nuk është as maja e ajsbergut.

Ka aq shumë për të thënë për ty dhe qeverisjen tënde, sa njeriu nuk di nga të fillojë.

Për këta muaj prejse je bërë kryeministër, ashtu siç u bëre, me qykë të zorit, ke bërë gabime pa numër, disa prej të cilave mund të quhen lirisht skandale.

Puna e parë që bëre me të ardhur

në krye të ekzekutivit ishte t'ia rrisje rrogën vetes. Vetes dhe të tjerëve rreth teje, me arsytimin qesharak: "duhet me ble këmisha e kravata" dhe "për mos me vjedhë!".

Kam pritur prej teje si njeri popullor që ta ulësh pak rrogën, qoftë edhe simbolikisht, e jo ta bësh krejt të kundërtën!

Kosova është vendi më i varfër dhe me papunësi më të lartë në rajon, me rrogë minimale prej 150-170 eurosh (çdo i dyti kosovar, sipas statistikës, jeton me më pak se 1 euro e 40 centë në ditë), kurse kryeministri i Kosovës së shpejti do të marrë pagë mujore prej tre mijë eurosh (fiks 2950)! Kryeministri i Shqipërisë ka pagë mujore 1700 euro, ai i Maqedonisë 1300, i Malit të Zi 1130, i Bosnjë e Hercegovinës 1070, ndërsa kryeministri i Serbisë, me traditë shtetërore dyqindvjeçare dhe me resurse shumë më të mëdha se Kosova e Shqipëria bashkë, merr rrogë mujore prej vetëm 1000 eurosh!

Paga e kryeministrit të Kosovës tash e tutje, pas vendimit absurd të Gjykatës Kushtetuese, do të jetë më e lartë edhe se ajo e kryeministrit të Kroacisë, paga mujore e të cilit është 2600 €.

Ke ardhur në krye të shtetit për t'i shërbyer popullit apo për të mbushur xhepat e tu? Po e zhatvni buxhetin e

**(Letër e hapur  
Ramush  
Haradinajt, që  
mund të  
shërbejë edhe si  
promemorie për  
të dhe  
pushtetarët e  
tjerë të Kosovës)**



Kosovës dhe pasuritë e saj si ujtit prenë!

Nuk të vjen pak keq për ne pensionistët e shkretë, profesorë, mjekë, juristë, ekonomistë, që po e ngrysim jetën me një pension prej 230 eurosh në muaj (nga 80 sa ishte në fillim!) pas dyzet vjet pune në Universitet dhe pas gjithë atij kontributi në arsim, shkencë, art, kulturë, ekonomi e edhe në politikë?

Po për hallexhinjtë e shumë të anembanë Kosovës, që mund të mos kenë as bukë në sofër dhe që s'kanë me se t'i blejnë ilaçet në barnatore?

Po e mbysni solidaritetin, virtytin, moralin, po e vrisni shpresën... Nuk kam thënë më kot në atë intervistë, me dhembje të madhe, natyrisht, se Kosova po vdes moralisht!

Derisa ishe në opozitë, ti ishe kundërshtari më i madh i demarkacionit me Malin e Zi sipas komisionit Meha. Me t'u bërë kryeministër, formove komisionin Bulliqi, por në fund, pas disa manovrash politike në relacionin Prishtinë-Podgoricë dhe pas blerjes së votave të disa deputetëve në Kuvend, demarkacioni u ratifikua sipas gjetjeve të komisionit të parë. Jo vetëm që i sakrifikove 8200 hektarë territor, por s'e pe të udhës t'i kërkoje falje Murat Mehës si burrë. Ndoshta nuk ke harruar se ia pate gjuajtur har-

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 26 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

tat në fytyrë dhe e pate quajtur publikisht "peder"?!  
 Je në krye të një qeverie, që ka pesë zëvendës-kryeministra, 21 ministri e po aq ministra dhe hiç më pak se 80 zëvendësministra, gjë që nuk ndodh askund në botë. (Kjo puna e zëvendës-ministrave të qeverisë sate është bërë proverbiale, aq sa po më dhimbjen disa nga ata djem, që, pa fajin e tyre, kanë rënë në pozitë të palakmueshme).

Të gjithë paguhen nga buxheti i Kosovës, që mezi arrin dy miliardë euro në vit!

Mbi çfarë baze ligjore i ndave 300 mijë euro për Grupin e Kumanovës dhe a mendove ndopak për pasojat politike që mund të ketë ky akt?

Ua fale borxhin kompanive të ujit dhe pyetjes së gazetares së RTK-së se si dhe përse ndodhi kjo gjë, iu përgjigje: "M'u ka tek!", si të ishin ato paratë e tua e jo të taksapaguesve të Kosovës. Pastaj, pas një kohe, t'u tek ndryshe dhe e tërhoqe vendimin, duke treguar kështu mungesë totale serioziteti në drejtimin e punëve të shtetit.

Po e keqpërdor pozitën e kryeministrit, duke marrë vendime arbitrare dhe duke u sjellë në mënyrë të papërgjegjshme, aq sa mund të thuhet se sjellja jote si kryeministër u ngjan, herë-herë, personazheve të vodvileve, pra është qesharake.

Deportohen nga Kosova gjashtë shtetas turq, të ashtuquajtur "gülenistë" dhe ti, kryeministri i vendit, del në televizor dhe thua: "Unë nuk di gjë!". Dhe vazhdon ta ushtrosh detyrën si të mos kishte ndodhur asgjë.

Si intelektual kam qenë kritik, madje shumë më kritik se ndaj teje, edhe ndaj Ibrahim Rugovës e Sali Berishës, edhe ndaj Fatos Nanos e Hashim Thaçit, edhe ndaj Ali Ahmetit e Menduh Thaçit, e edhe ndaj paraardhësit tënd, Isa Mustafës, por asnjëri nga ata nuk ka ndodhur të më ndalë në rrugë e të më thotë: "Nuk merr vesh nga punët e politikës!", siç veprime ti në mbremjen e 5 qershorit.

Si ta marr këtë: si një "qortim miqësor" apo si kërcënim për të mbyllur gojën, sepse je njeri i veshur me pushtet, hiç më pak se Kryeministër?

Uroj që të jetë e para, qoftë edhe si non sens, sepse e dyta përbën një precedent të rrezikshëm.

Nuk e kam ditur se je kaq i ndjeshëm ndaj kritikës; kam kujtuar se je tolerant e zemërgjerë, edhe pse e di se nuk le gur pa luajtur për t'u bërë kryeministër.

Je i rrethuar, jeni të rrethuar, si ti, ashtu edhe Hashimi, me këshilltarë servilë, që i kanë ndër-ruar padronët njëqind herë në këta njëzet vjet. (Nesër, kur të bini nga froni, ata do t'ju kthejnë shpinën të parët).

Ti, i dashur Ramush, gati për çdo ditë e bën nga një skandal.

Edhe në manifestimin që u mbajt në Prizren më 10 qershor, u solle jo si kryeministër, por si bodigard, duke e larguar me dhunë nga tribuna mbesën e Mehmet pashë Derrallës, pjesëmarrës i Kuvendit të Prizrenit dhe Ministër i Luftës në Qeverinë e Vlorës të kryesuar nga Ismail Qemali.

140-vjetori i Lidhjes së Prizrenit do të mbahet mend për karriget e zbrazëta, për programin e dështuar dhe posaçërisht për përleshjen tënde me një grua të moshuar.

Të nesërmen, në konferencë shtypi, në vend që të shprehje keqardhje e të kërkoje falje për këtë veprim skandaloz, deklarove me mburrje para gazetarëve: "Me pas' qenë burrë edhe ma ndrysh' e kisha kry!".

Bravo, Kryeministër! Të lumtë, he burrë!

Uroj që ky të jetë skandali yt i fundit, por si ia ke nisur kam frikë se skandalet e tua s'do të

kenë të ndalur.

A je i vetëdijshëm se me sjelljet dhe veprimet e tua e komprometon rëndë institucionin e kryeministrit dhe vetë shtetin që përfaqëson?

Ti dhe këshilltarët e tu mund të mendoni se unë flas kështu për hir të "Vetëvendosjes". Jo. Për hir të Kosovës. Nesër kur të vijë në pushtet VV-ja, nëse vjen, do të jem kritik edhe ndaj Albinit me shokë, ashtu siç jam sot ndaj jush.

Nuk jam anëtar i asnjë partie politike, as nuk kam qenë, kam refuzuar të jem, i bindur se detyrë e intelektualit është të jetë opozitar i përhershëm, sepse çdo pushtet, qoftë edhe më i miri (o Zot, çëndërr e largët!), kurrë s'është i përsosur.

Kam folur dhe kam shkruar për meritat e tua në luftë. Ato s't'i mohon kush. Unë aq më pak. Kam bërë diçka për ty edhe kur të morën në Hagë; të kam mbrojtur në media e tubime, brenda e jashtë dhe, madje, kam pasë shkruar edhe një poezi, në të cilën hasen edhe këto vargje: "Ave, Evropë, Zonjë hijerëndë,/ me Muze Armësh e Sheshe Invalidësh,/ përse kërkon nga unë t'i fshij nga memorja shkronjat UÇK?!/ E përse djemtë m'i degdis në Hagë e m'i mbyll në Dubravë,/ në atë hapsanë larë me gjak e lot?!/ Përse, madhëri, nënë luftërash e shtetesh e liri-sh;/ Më thua përse,/ pash Shën Bartolometë dhe Bonapartët e tu të shumtë/ e funeralet e tua madhështore në natën e gjatë të historisë?".

Besoje se e kupton se fjala është për ty dhe shokët e tu; për ju që patët guximin t'i kundërviheshit pushtuesit shekullor në një luftë tmerrsisht të pabarabartë, e cila, falë rrethanave të krijuara, përfundoi me çlirimin e Kosovës. E kam shkruar në vitin 2005, kur ti dhe dy bashkëluftëtarët të tutë gjykohehit në Hagë me akuzën për krime lufte dhe mund ta lexoni të plotë, nëse doni, në librin tim Nostalgji për kohërat e rrezikshme (2017).

Me gjithë respektin që kam për ty si luftëtar dhe për familjen Haradinaj, që i ka dhënë shumë Kosovës, lirisë së saj, nuk mund të heshiti për gafat që po bën si kryeministër, duke e qeverisur keq vendin dhe duke promovuar një kulturë sjelljeje që nuk përkon aspak me postin që mban.

U bënë 19 vjet nga mbarimi i luftës dhe çlirimi i Kosovës dhe 10 vjet nga shpallja e saj shtet i pavarur. Por a është kjo Kosova për të cilën kemi luftuar, ju me pushkë e ne me penë dhe për të cilën dhanë jetën djemtë e vajzat e Kosovës, dëshmorët tanë, përfshirë edhe vëllezërit e tu, Luan e Shkëlzen Haradinaj?

A është kjo Kosova për të cilën u derdh gjak dhe u bënë aq shumë sakrifica? Jo, mjerisht jo, njëqind herë, një mijë herë!

Korrupsion, nepotizëm, zhvatje parash publike, gënjeshtër, mashtrime, hipokrizi, premtime boshe, shpenzime pa mbulesë, mungesë transparence, pasurim marramendës i një grupi njerëzish, oligarkësh, në njërën anë dhe varfërim i pandalshëm i shumicës së popullit, në anën tjetër; luftë për pushtet, dallavere, imoralitet, brutalitet, reket, krime e dhunë në çdo hap. Dhe zhgënjim e dëshpërim pa fund!

Situata në të cilën gjendet Kosova sot do të mund të karakterizohet me fjalët e dy shkrimtarëve të mëdhenj francezë të shekullit të 19-të, Stendalit dhe Merimesës. "Jemi zhytur në baltë deri në fyt...", i shkruante i pari të dytit, Stendali Merimesës, në kohën e Restaurimit, kurse ky i fundit ia kthente: "Ke të drejtë dhe po të mos më vinte turp nga vetja do të thosha se jemi zhytur në m...".

Prishtinë, 11 qershor 2018

P.s. Botimi i këtij shkrimi u shty për shkak të vdekjes së babait të Kryeministrit, z. Hilmi Haradinaj.

# Dashuria ndaj Atdheut nuk tregohet me përralla



Nga Delvina KËRLUKU

Në udhëtimin e fundit në Kosovë, këto ditë, vizitova universitetin, pastaj Akademinë e Shkencave dhe Arteve dhe fare në fund i rashë bulevardit. Si përherë ndalem dhe e shoh bustin e Ibrahim Rugovës, pastaj shtatoren e Skënderbeut dhe kur i shkoj deri në fund bulevardit e shkrepim një foto, në të cilën futet edhe fotografia me simbolin e Pavarësisë së Kosovës, e varur në një ndërtesë shumëkatëshe. Gjatë kësaj ecejakeve të shkurtër të vie fluturimthi ndërmend gjithë historia e këtij vendi. Librat e strukur në vitrinë, përgjatë shetitores, joshin lexuesit me padjallëzinë e tyre.

Në këtë 'përhumbje' kthjellsh nga zërat e kalimtarëve. Pëshpëritje publike për papunësinë, për mungesën e vizionit të pushtetmbajtësve, që kanë lënë ekonominë në stagnim, për BE-në që nuk është fajtorë për dështimet e qeverisë, të shantazhuarit në pushtet, të rrezikshëm për Kosovën, për ata që refuzojnë Evropën e duan një shtet tribal, për largimin e të rinjve etj. Pas shumë problemeve që ka Kosova, i vetmi gëzim momental i atëditshëm ishte shqiptari që nuk e shpalli hero pushtuesin. Bëhej fjalë për futbollistin shqiptar Xherdan Shaqirin (duke mos përjashtuar edhe futbollistin Granit Xhaka), pjesë e kombëtares së Zvicrës. Futbolli botëror 2018, na risjell ndërmend emigrantët shqiptar që kanë ikur nga vendi, për një jetë më të mirë, për të mbijetuar, për të pasur përparim më të madh brezat e rinj. Dhe pikërisht sot këta të rinj shqiptar i gjejmë në majat e sportit, kulturës, artit, shkencës. Krenaria që na sjellin pas fitores në aktivitet e tyre, na bën të vetëdijsohemi se largimi i shqiptarit jashtë vendit është i dobishëm për Atdheun. Por, frika për t'u asimiluar shqiptarët nëpër vendet e botës, ekziston. Pikërisht, kjo dilemë u rrënjos me mospjesëmarrjen në kombëtaren e Shqipërisë a të Kosovës, nga futbollistët shqiptar që luajnë në kombëtaren e Zvicrës, Gjermanisë, Belgjikës, etj. Ata u quajtën 'tradhtarë', 'të shitur për para', 'njerëz pa ndjenja kombëtare'. Këta zëra lëshues nuk kanë dëgjuar rrëfimet interesante dhe prekëse të këtyre djemve dhe në përgjithësi të familjeve shqiptare, të emigruar. Për shtëpinë e vjetër të Shaqirit në një fermë në Basel, për varfërinë e tij, për mallin e Kosovës etj. Ndonëse, edhe mund të thuhet se Kosova ka qenë larg syve të këtyre djemve, po kurrë larg zemrës.

Fitorja e lojës së futbollit të Zvicrës

**Nga gjithë ky gëzim, kuptova se sporti nuk është politikë, por ndjenjë atdhedashurie.**

**Pikërisht në këpucët e Shaqirit, janë të vendosura flamujt e Shqipërisë, Kosovës dhe në këpucën e majtë atë të Zvicrës, jo për shkak të politikës, por për të treguar historinë e jetës së tij. Për shumë kosovarë, futbolli botëror 2018 kishte përfunduar me humbjen e Serbisë dhe fitoren e djemve shqiptar në kombëtaren e Zvicrës**



ndaj Serbisë është historike, sepse pikërisht djemtë shqiptar të Kosovës i sollën fitore spektakulare kombëtares së Zvicrës, dëshmuan fuqinë, heshtën Beogradin, Serbinë e Kalingradin. Ndërsa, ua mbyllën gojën zërave të ligë e i krenuan shqiptarët, duke triumfuar ndaj Serbisë, pushtuesit të kosovarëve dhe duke u identifikuar si shqiptar e jo zviceran, duke përdor simbolin e shqiptarëve, shqiponjën. Dhe fill pas kësaj fitore të lojës së futbollit, shqiptarët e Kosovës u kthehen punëve të tyre më me vullnet. Dhe nga gjithë ky gëzim, kuptova se sporti nuk është politikë, por ndjenjë atdhedashurie. Pikërisht në këpucët e Shaqirit, janë të vendosura flamujt e Shqipërisë, Kosovës dhe në këpucën e majtë atë të Zvicrës, jo për shkak të politikës, por për të treguar historinë e jetës së tij. Për shumë kosovarë, futbolli botëror 2018 kishte përfunduar me humbjen e Serbisë dhe fitoren e djemve shqiptar në kombëtaren e Zvicrës. Ndërsa, tek të gjithë shqiptarët anë e mbanë botës, kthejnë kokën nga simboli shqiptar, ndjejnë krenari dhe forcë, që këta djem janë luftëtar, heronj dhe të gjithë i bëjnë që Kosovën e Shqipërinë ta kenë aty, mjafton të zgjatim dorën dhe ta fusim në gji. Këta djem na treguan se dashuria ndaj Atdheut nuk tregohet me përralla, që nuk i beson njeri, por me fakte.

Është një qytet i themeluar në 1979 në Rusi. Aty besohet se po zhvillohet një projekt i rëndësishëm, por nuk dihet se çfarë. Përveç qytetarëve askush nuk mund të shkelë aty pa një leje nga autoritetet.

Arkivat e Vatikanit – Për të është folur dhe shkruajtur shumë. Arkivat e Vatikanit janë aq të shumta sa dhe të vjetra. Thuhet se në këto arkiva ka dokumente me një gjatësi prej 84 kilometrash dhe 35 mijë volumesh. Të rrallë janë ata që mund të futen dhe vetëm me lejen e Papës.

Klubi 33 – Është një klub privat ku anëtarët kanë ekskluzivitet dhe askush nuk mund të hyjë. Gjetet në Disneyland, Kaliforni.

Zona 51 – Është e vendosur në shkretëtirën e Nevadës dhe është 133 kilometra larg Las Vegasit. Për të janë bërë libra dhe filma. Ajo shfrytëzohet për zhvillimin dhe testimin e armëve dhe mjeteve ajrore.

Sanktuari i Ise – Është një ndër vendet më të shenjta në botë dhe ndodhet në Japoni. Ai është dedikuar perëndeshës së diellit, Amaterasu. Ai ndërtohet, prishet, dhe rindërtohet çdo 20 vjet si një koncept i rilindjes ku besojnë japonezët. Aty mund të hyjnë vetëm priftërinjtë dhe ata që i përkasin familjes perandorake japoneze.

# SHTATË VENDET MË SEKRETE NË BOTË, KU ASKUSH NUK MUND TË SHKELË



Dhoma 39 në Korenë e Veriut – Dhoma e fshehtë 39 u krijua nga Kim Il-sung (gjyshi i Jong-un) në fundin e viteve 1970, dhe mendohet që tani fiton më shumë se 2 miliardë dollarë në vit duke falsifikuar "supermonedha" amerikane,

prodhuar dhe trafikuar drogë si heroina dhe metamfetamina, shitur cigare dhe ilaçe të falsifikuara, si dhe përmes mashtrimeve të skemave të sigurimeve. Veprimtaria kriminale në shkallë të gjerë është një pjesë integrale e ekonomisë së

Koresë së Veriut. "Jo vetëm paguan", thotë politologu David Asher, "por edhe i shkon për shtat strategjisë së tyre për të dëmtuar interesat perëndimore". Ai shton: "Në një kuptim, Dhoma 39 është si një bankë investimesh. Ofron paratë

për gjërat që ka nevojë Kimi". RAF Menwith Hill – Është një bazë e avioacionit britanik e vendosur në Harrogate. Ajo sjell mbështetje inteligjence dhe komunikacioni për ushtritë britanike dhe amerikane

## PEMËT E JETËS PO VDESIN



Pema baobab (Adansonia) e njohur ndryshe si "pema e jetës" është e vështirë për t'u harruar. Gjendet në rajonet e savanës afrikane, në Madagaskar dhe në Australi. Pemët formojnë një trung shumë të trashë dhe të gjerë dhe mund të jetojnë mijëra vjet e të zhvillojnë vrima kaq të mëdha, kavitete të pazakonta, saqë mund të strehojnë një bar në brendësi (Sunland Baobab). Sunland Baobab me moshë 1000 vjeçare dhe pema më e madhe e Afrikës u rrëzua vitin e kaluar. Një tjetër baobab i famshëm, pema Chapman në Botsvana u rrëzua në vitin 2016. Sipas një studimi të publikuar në "Nature Plants" diçka e ngjashme po u ndodh baobabëve më të mëdhenj dhe më të vjetër në të gjithë botën, një ngjarje me një magnitudë të paprecedentë. Studimi u realizua nga Adrian Patrut në universitetin e Babes-Bolyai në

Rumani dhe një grup ekspertësh, të cilët arritën në përfundimin se në 12 vitet e fundit 9 nga 13 pemët më të vjetra dhe 5 nga 6 më të mëdhatë kanë marrë fund. Po flasin për një humbje tragjike duke patur parasysh historinë dhe kulturën lidhur me këto pemë që janë edhe një burim kyç ushqimi për qeniet njerëzore.

Baobabi është shkaku i angiospermës (lulëzimit të bimëve) më të madhe dhe është pema embleme e Afrikës, sqaron Patrut. Shkencëtarët kanë ekzaminuar pemët qysh prej 2005 dhe kanë ngritur një teori se si rriten dhe kanë dokumentuar këto humbje të pariparueshme të natyrës. Baobabët më të mëdhenj kanë shumë trungje rreth një kaviteti fals dhe kjo e bën strukturën e e tij të veçantë. Këto trungje mund të rriten bashkë, çka çon në një karakteristikë të çuditshme sepse duke u

rritur nga jashtë brenda kavitetit druri mplaket gjatë një periudhe në vend që ta bëjnë më të ri siç do të ndodhte normalisht. Është një karakteristikë unike e baobabit, tha Patrut që ka përdorur metoda me radiokarbon për të përcaktuar moshën në pjesë të ndryshme të pemëve. Autorët thonë se pemët më të mëdha janë më të çenueshme dhe fajësojnë ndryshimet klimatike edhe pse studimi thotë se duhen kërkime të mëtejshme. Pemët më të mëdha kanë më shumë nevojë për ujë dhe ushqyes, sesa ato më të vogla dhe janë më të prekura nga rritja e temperaturave dhe nga thatësira. Ky studim hedh poshtë idenë se këto pemë po mbarojnë nga ndonjë epidemi kërpudhore ose diçka e ngjashme. Këto vdekje janë modifikime të rëndësishme në ekosistemin dhe integritetin e biodiversitetit. /bota.al

## RUSËT NUK E KUPTUAN SE PO PUSHTOHESHIN

Nga arkivat e Moskës, kanë dalë dokumentet origjinale të cilat përligjin atë që historianët e dyshonin prej kohësh: sulmi i Hitlerit i zuri rusët në befasi sepse deri në fund, ata menduan se ishte i gjithi një bllof! Në orët vendimtare përpara mësymjes gjermane të 22 qershorit 1941, të njohur ndryshe si operacioni Barbarosa, komanda e lartë sovjetike i kishte dërguar trupa mesazhe kontradiktore.

Usharët urdhëroheshin të qëndronin në gatishmëri, por të mos i përgjigjeshin provokimeve. Edhe kur tre milionë gjermanë sulmuan në 04:00 të mëngjesit përgjatë gjithë vijës së frontit perëndimor me 3500 autoblanda dhe 600.000 makina të tjera, rusët nuk reagon nga frika se kështu mund të

kundërshtonin vullnetin e Stalinit.

Kundërsulmi do të niste vetëm në 07:15, pra mbi tre orë me vonë, çka u kishte lejuar nazistëve të fitonin ndjeshëm epërsi.

Dokumentet u publikuan në 77-vjetorin e këtyre ngjarjeve. Ato tregojnë se edhe kur ishte dhënë urdhri i goditjes, trupave u kërkohet të hidheshin mbi armikun dhe ta shkatërronin, por pa e kaluar kufirin. Deri në ato momente rusët kishin marrë sakaq goditje të forta, me 1200 avionë të shkatërruar përpara se të ngriheshin në fluturim.

Stalini deri në çastet e fundit duket kishte qenë i bindur se ky ishte një lloj provokimi i Gjermanisë për të hapur negociatat me të.



## Del në ankand avioni i braktisur i Elvis Presley

Në kohët e arta, Elvis Presley kishte tre aeroplanë. Momentalisht dy janë në Grace-land, në shtëpinë e ish-rokerit të famshëm në Memphis, Tennessee. Një, në pronësi private, është mbajtur për 36 vjet në aeroportin e vogël të Rossëell, në Nju Meksiko dhe do të dalë në shitje në internet me një çmim të vlerësuar rreth 2-3 milionë dollarë.

Ofertat pranohen deri më 27 korrik. Lockheed JetStar 1329 i vitit 1962, nga fotot e publikuara në ankand, Shtëpia e ankandit të Iron Planet, duket si një grumbull hekurash i kthyer në skrap, është pa motor, i ndryshkur plotësisht. Modeli është mjaft i rrallë, pasi ndërmjet 1957 dhe 1978 janë bërë vetëm 204 ekzemplarë.



## KOPE DELESH “MËSYJNË” PARISIN

Një tufë delesh mund t'i shohësh teksa shëtisin të pashqetësuar nëpër rrugët e Parisit. Një imazh i pazakontë dhe nuk është një marifet i ri publik ose një skenë në ndonjë film të Hollivudit.

Është e gjitha e vërtetë. Kullimi i qytetit zhvillohet një herë në muaj, në parkun Aubervilliers, jashtë kryeqytetit francez. Krijuesi i

këtij projekti kurioz dhe inovativ është një arkitekt i hapësirave urbane, Julie-Lou Dubreuilh, që pesë vjet më parë krijoi një kooperativë profesionale “në teknikat e qytetit”, që ka për qëllim të sjellë “Paqe rurale” madje edhe në metropol.

Çdo tridhjetë ditë, disa barinj mund të marrin kopenë e tyre për ta kullotur në rrugët e Parisit. “Delet gjithmonë sillen në një mënyrë

të disiplinuar”, shpjegon Julie-Lou Dubreuilh.

“Qyteti mund të jetë i dobishëm për kafshët dhe kafshët mund të bëjnë mirë për qytetarët që i shohim të çlodhur, teksa në jetën e përditshme ndjehen të zhytur në një dimension baritor”, sh-ton ai.

“Duket e çuditshme,” vazhdon Dubreuilh—“por në qoftë se ju doni

bagëti pa përdorimin e antibiotikëve, ju duhet t'i jepni deleve një shans për t'u kujdesur për veten e tyre”.

“Kjo do të thotë që bimët, të cilat rriten në shtigje dhe tokë të papunuar që shpesh gjenden në qytet, përshembull Artemisia, janë të përsosura për t'u shfarosur nga delet edhe në një metropol të madh si Parisi”, thekson ai.



## Italiani i lë 4 milionë euro trashëgimi qytezës që drejtoi

Carlo Nicoli (Dc) ka lënë si trashëgimi katër milionë euro në Bashkinë e Fornovos San Giovanni, qendra e 5 mijë banorëve të Bergamos së ULët, të cilën e kishte administruar në vitin 1962 dhe 1975.

Kjo u njoftua, papritur nga kryetari aktual, Gian Carlo Piana, gjatë këshillit të fundit bashkiak të qytetit.

Ish kryetari i bashkisë vdiq në moshën 85-vjeçare dhe i la të gjitha pasuritë e tij në qytet, përcjell gsh.

Nicoli vdiq në dhjetor 2016 dhe procesi i gjatë burokratik për të formalizuar dhe përcaktuar sasinë e trashëgimisë përfundoi një vit e gjysmë më vonë: dy milionë e gjysmë euro vetëm midis parave kesh, aksioneve dhe letra-ve me vlerë, plus tre apartamente në Bergamo, një në Treviglio, tokë dhe një vilë në fshat. Për një total prej rreth katër milionë euro.

“Burimet do të përdoren për krijimin e punëve dhe shërbimeve publike, e njihja Nicolin nga shtëpia, ai ishte një person shumë i rezervuar, nuk do ta kisha pritur këtë gjest që na nderon”, deklaroi kryetari aktual.

## Pjesë të serialit “Game of Thrones” janë filmuar shumë pranë nesh

Dubrovniku është qyteti përrallor i Kroacisë, është zonë e mbrojtur nga UNESCO dhe shquhet si “perla” e Adriatikut, me një pozicion strategjik dhe arkitekturë mahnitëse nga stili barok dhe gotik duket se ka qenë vendi ideal për xhirimet e serialit.

Që nga transmetimi i “Game of Thrones” nga HBO, në Dubrovnik janë shtuar ndjeshëm

turistët.

Prandaj duhet ruajtur arkitektura, veprat, monumentet e çdo gjë tjetër që krijon lidhjen e një vendi me të kaluarën dhe identitetin e tij. Nëse në Maqedoni, Shqipëri, Kosovë do ishte ruajtur më mirë kultura dhe natyra kushedi edhe sa turistë më tepër do tërhiqnin këto vende.



Në duartë e lexuesve së shpejti do të vijë një libër unikat që përmban një thesar të madh materialesh mbi veprën dhe jetën e doajenit të teatrit dhe filmit, Bajrush Mjaku

Që në kapitullin e parë aktorit, prej momentit kurë shfaqja mbaron jetën e vetë në skenë, i mbaron edhe një pjesë e jetës së tij, kreacioni i tij mbetet vetëm në kujtesën e tij e të konsumuesit.

“Gjatë karrierës sime të bujshme në Teatrin Shqiptar (44 vite), kanë lindur apo realizuar do thojë Shfaqje antologjike, por në kujtesë na kanë ngelur neve aktorëve apo edhe ndonjë dashmiri të teatrit dhe prononcimet e ndonjë kritiku të teatrit në gazeta të ndryshme anë e mbanë botës.

Me punësimin tim si aktor në Dramën Shqiptare të asaj kohe (mars i vitit 1973) e gjer më sot me fanatizëm të madh kam ruajtur – arkivuar çdo shkrim, apo prononcim në gazeta nga kritikë të teatrit nga brenda dhe jashtë vendit e që kanë të bëjnë me shfaqjet ku unë kam luajtur (100 Shfaqje – role)”, shkruan Bajrush Mjaku.

Libri është i ndarë në tre kapituj, ku në fakt kam mundur që të botoi tri libra, por duke dashur që gjërat të regjistroi në kontinuitet vendosa që të botohet një libër.

300 faqet e para të librit “Urtësi e Marrëzi”, përfshijnë 35

SË SHPEJTI

## LIBRI “URTËSI E MARRËZI” - BAJRUSH MJAKU



shfaqjet e Teatrit Shqiptar të Shkupit të cilat me të drejtë do thojë se janë shfaqjet më reprezentative të teatrit, shfaqje që i kanë bërë historin e teatrit dhe gjithësesi janë shfaqje që i kanë bërë nder kulturës teatrore shqiptare, dhe se jam i sigurt se ky Libër do jetë një dokument i bazuar në fakte – argumente dhe se pikërisht ky libër do jetë më se i vlefshëm për historikun e Teatrit Shqiptar.

Momenti i dytë apo kapitulli i

dytë në këtë libër përfshinë punën e Produksionit për teatër dhe filëm “B.M” e më vonë ky produksion shndërrohet në ndërmarrje për kulturë “Teatri i një aktori”.

“Zënkat dhe mosmarrveshjet në relacion unë dhe drejtorija e teatrit kishin arritur në një fazë kritike deri sa isha i gatshëm të ik nga teatri, por jo, vendosa që të regjistroi një “Organizatë jo Qeveritare”, produksion të pavarur, ku mund të provoi aftësitë e mia të verifikuara në planin e menagjue-

sit.

Më kishin ngel disa personazhe nga dramaturgjia botërore pa i realizuar e që i kisha si pikë synim personazhet si: Poprishkini në “Ditarin e një të Çmenduri”- Gogol, Kapiteni Adolf në “Babai”- Stryndberg, Vojnicki në “Daja Vanja” – Çehov, Sokrati në “Mbrojtjen e Sokratit” – Platon, Dr. Stockman në “Armikun e popullit” dhe Peer Gynti në “Peer Gynt” – Ibsen.

Falë produksionit tim të pavarur unë iu ktheva vetvehtës dhe

pikërisht me këto personazhe arrita të realizoi ëndrrën time dhe të realizohem si aktor. Mes tjerash në produksionin e pavarur realizova shfaqjen “Kërkohe një klloun plak” – Matei Visnek në regji të Besfort Idrizit dhe një film televiziv “Librat e Babait” – Luan Starova si dhe mu dha rasti të provoi vehten edhe në planin e regjizurës ku me shumë sukses realizova shfaqjen “ZOO STORY” – Eduard Olbi.

Fal këtyre shfaqjeve të lartpërmendura u nderova me shumë çmime – vlerësime nga juri profesionale dhe kuptohet se kënaqësija ime më e madhe është se pikërisht me këto shfaqje, në mënyrën më të denjë kam arritur që Kulturën teatrore gjithshqiptare ta prezantoi në Evropë, Azi, Afrikë, Amerikë, Botën Ruse, Botën Arabe” nënvizon Mjaku.

Më tej ai shkruan: “Nga 100 role që i kam realizuar për 44 vjet si aktor profesionist, 43 role i kam realizuar jashtë repertuarit të Teatrit Shqiptar, kapitulli i tretë regjistron pikërisht angazhimin tim jashtë skenës së teatrit shqiptar.

Do hasni në katër intervista, dhënë Revistës për teatër në gjuhën Bullgare, një intervistë dhënë revistes Lobi me rastin e tridhjetvjetorit të punës sime në teatër, një intervistë dhënë të përditshmën “Pobjeda” nga Mali i zi, dhe intervisten dhënë të përditshmës “Koha”.

Këtu do hasni dhe në disa prononcime – mospajtime të mijat në gazetë, zënka të llojeve të ndryshme që më kanë përcjellë e që po më përcjellin edhe sot kurë jam i pensionuar dhe kurë Librin veq e kam mbyllur” shkruan në mes tjerash për librin e tij, Bajrush Mjaku.

## EQREM ÇABEJ, përgjithmonë në oborrin e Akademisë së Shkencave

Me sytë e mbyllur dhe duart e vendosura mendueshëm, Eqrem Çabej do të jetë përgjithmonë në oborrin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Vepra e realizuar nga Hektor Dule është përvuar në një ceremoni ku merrte pjesë dhe kryeministri Edi Rama si dhe vajza e gjuhëtarit Brikena Çabej.

“Thuhet se bustet ashtu si pemët shekullore, nuk qendrojnë dhe zenë vend rastësisht në tokë. Për to, duket se në mënyrë të pashmangshme, koha, natyra dhe njerëzit, përzgjedhin e selekcionojnë “farat” e forta, e gjithçka që mbart histori, kuptim e vlerë. Pastaj, befas, ashtu si pa kuptuar, në një ditë të caktuar vetëm llojet e duhura, ato “mbijnë” e zënë vend përgjithnjë, ashtu edhe bustet si

ky i akademik Çabejt që do të përvurojmë sot.

Po çfarë Çabej ishte, është dhe do të mbetet për ne? Ai është më së pari një simbol, simbol i shkencëtarit dhe i atdhetarit, i ndërgjegjes shkencore dhe i ndërgjegjes qytetare, i fisnikërisë njerëzore dhe i moralit njerëzor, kjo e provuar vijueshmërisht në tre sisteme: gjatë mbretërisë, pushtimit nazifashist të vendit si dhe komunizmit.

Vepra dhe personaliteti i Tij hapi një periudhë të re në historinë e shkencës filologjike shqiptare dhe e bëri atë epokë, pasi shënoi kalimin nga faza parashkencore e diletantizmit romantik në fazën shkencore të mendimit pozitivist, duke e integruar dijen albanologjike shqiptare në proceset e zh-

villimit të gjuhësisë bashkëkohore”, u shpreh akademik Vasil S. Tole, sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave.

Sipas tij, Çabej është edhe një figurë emblematike e shkencës dhe e kulturës shqiptare. Vepra e tij rroku disa fusha të dijes albanologjike: gjuhësinë historike dhe veçanërisht etimologjinë, gjuhësinë e krahasuar dhe studimet historiko-letrare të krahasuara, etnologjinë dhe veçanërisht folkloristikën, mitologjinë dhe dialektologjinë historike, leksikografinë dhe kulturën e gjuhës.

“Eqrem Çabej është i pari gjuhëtar shqiptar që trajtoi e zgjidhi në nivelin e dijes e të shkencës botërore probleme themelore të albanologjisë me të cilat



ishin marrë para tij emra të mëdhenj të gjuhësisë botërore, pasi “për mendjen e hapur të Eqrem Çabejt nuk ka pasur konflikt midis vatrës dhe botës”.

Sot Çabej është shndërruar vetë në një nga këta emra të mëdhenj të gjuhësisë botërore, emër që sot e mban më së pari vepra e Tij, e mban universiteti në

qytetin e tij të lindjes në Gjirokastrë, fondacioni që ruan dhe promovon trashëgiminë e tij akademike si dhe çmimi Çabej, më i rëndësishmi vlerësim që Akademia e Shkencave akordon çdo vit për studimin dhe botimin më të mirë në fushë të shkencave albanologjike e shoqërore”, tha Tole. (Gazeta Shqip)

# LUÇIA NADIN ZBULON NË PARIS DORËSHKRIMIN MË TË HERSHËM TË BARLETIT

Studiuesja e njohur Luçia Nadin së bashku me historianin Aurel Plasari kanë prezantuar dje punën e përbashkët për zbulimin dhe interpretimin e dorëshkrimit të Marin Barletit të gjysmës së dytë të shek. XV: "Marini Barletii, Scodrensis Sacerdotis, jurisque pontificii Scholaris, ad Augustinum Barbadicum, Venetae aristocratiae Ducem, ejusque Senatam, de bello Scodrensi brevissimus libellus", të gjetur në Bibliotekën Kombëtare të Francës, por e prejardhur nga Biblioteka e famshme e mbretit francez, Mazarine. Së shpejti riprodhimi i këtij dorëshkrimi do të mbërrijë edhe në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë

Përmbysët historia e "Rrethimit të Shkodrës". Mjaft historianë dje kanë mëmëritur, duke u befasuar por ndoshta dhe dyshuar mbi zbulimin më të fundit që vjen nga Biblioteka Kombëtare e Parisit. Edhe këtë herë është studiuesja e njohur italiane Luçia Nadin, që në moshën 80-vjeçare, po bën pothuaj punën e një institucioni të tërë akademik duke prezantuar dje në Tiranë, për herë të parë një dorëshkrim të panjohur të Marin Barletit, autorit të "Historisë së Skënderbeut" dhe "Rrethimit të Shkodrës". Së bashku me studiuesin Aurel Plasari kanë bërë të njohur një dorëshkrim, kodik të vitit 1500, që mendohet të jetë kopja më e hershme e librit "Rrethimi i Shkodrës", të cilin Marin Barleti e ka botuar për herë të parë në Venedik, në vitin 1504.

Prezantimi i këtij libri u bë në Konferencën Ndërkombëtare Albanologjike kushtuar Gjergj Kastriot Skënderbeut, në 550-vjetorin e vdekjes së tij. Në fjalën e saj, Nadin u ndal në kërkimin e saj duke thënë se: "Ishte një kërkim i gjatë, derisa ndesha në këtë libër. Unë kisha kërkuar botimet e Barletit dhe deri në këtë kohë kisha hasur të gjitha botimet që ishin nga viti 1504 deri në 1510-n nga Benetino Vitali. Gjetja e këtij dorëshkrimi është një dritare e panjohur. Ky dorëshkrim kërkon studime e analiza më të thelluara. Dorëshkrimi ka shënime të ndryshme, por duhet bërë analiza, nëse është dorëshkrim apo një libër më i hershëm i botuar. Aty vihen re disa të dhëna të ndryshme nga varianti i botuar i "Rrethimit të Shkodrës". Për shembull vihet re se versioni i parë i botimit të paragrafi i "Rrethimit të Krujës" ka ndryshuar dhe vjen më i përpunuar. Ky version është interesant sepse sjell një përpunim të gjuhës dhe të dhënave. Teksti në çon edhe në krahasimin e veprës së Marin Barletit me atë të Marin Biçikemit. Por duhet pasur parasysh se këta autorë kanë një ndryshim të madh, ndërsa Barleti shkruan për historinë dhe ngjarjet e rëndësishme, Biçikemi shkruan më shumë për historinë e familjes dhe fisit të tij", tha studiuesja italiane.

## NGJARJE RRALLË PËR KULTURËN TONË

Për studiuesen Nadin kjo është një ngjarje e rrallë për kulturën tonë, pasi është një dorëshkrim i veçantë që përmbys disa të dhëna historike.

"Ky dorëshkrim na lë të kuptojmë se Barleti zotëron të dhëna që i përkasin fundit të 1400-s dhe kjo na lë të kuptojmë se ai ka shfrytëzuar në historiografinë e tij dokumente edhe më të hershme që i afrohen më tepër periudhës kur jetoi Skënderbeu", tha Nadin.

Edhe studiuesi Aurel Plasari ka vlerësuar rëndësinë dhe diferencën e dy botimeve për të njëjtën ngjarje historike: "Varianti i botuar i "Rrethimi i Shkodrës" çmohet si vepra e parë e letërsisë historiografike shqiptare. Gjetja e një dorëshkrimi më të hershëm në Francë, që ishte bërë dhuratë Kardinalit Mazarini me origjinë italiane dhe mik i familjes së madhe Durrazzo, çel siparin e kërkimit të shkrimeve më të hershme rreth historisë së Skënderbeut. Profesoresha italiane Lucia Nadin, është shumë e njohur në Shqipëri për kontributin e saj në fushën e kërkimeve historike mbi marrëdhëniet midis Republikës Venedikase dhe Shqipërisë".

## MBIVENDOSJA E HISTORISË

Studiuesi Aurel Plasari ka folur më gjatë për rëndësinë e këtij dorëshkrimi, duke interpretuar rrethanat në raport me veprën e njohur deri tani, por që sipas studiuesit mbajnë dy histori të ndryshme. Duke kujtuar përballjen, rivalitetin që patën Barleti me Beçikemin, Plasari i shpjegon në këtë mënyrë kontekstet e mbivendosjes së historisë me zbulimin e dorëshkrimit: "Rëndësi paraqet ky dorëshkrim, qoftë dhe si skaj të fundit ka vitin 1500, pra në diferencë nga botimi i vitit 1504. Çfarë shkakton në studimin e historisë së asaj epoke, dhe në veprën e Barletit? Viti 1504 është vendosur, kontekstualizuar vepra e Barletit në rrethanat e paqes që bënte republika e Venedikut me Turqit, 30 maj 1503, dhe ratifikuar më 30 qershor 1503. Pra, është menduar, dhe autorët që kanë shkruar për këtë vepër e kanë vendosur në

rrethanat e një paqeje. Fakti që dorëshkrimi na del maksimumi i 1500-ës, vite më përpara, na e ndryshon këtë të dhënë, ndaj duhet të bëjmë një rivendosi tjetër, që është çfarë ndodh në vitet 1499 dhe 1501 kur është shkruar në të vërtetë dora e parë e veprës së Barletit e "Rrethimi i Shkodrës". Është e kundërta, nuk janë rrethanat e paqes por në Shqipëri ka ndodhur kryengritja e Lezhës, ka ndodhur zbritja në Arbëri e "Skënderbeut të ri" e ftuar nga arbri, subjekt që e ka përmendur në leksionin e tij edhe profesor Xhufi, me projektin e marrjes së Krujës dhe të Shkodrës. Pra, tashmë dy-tre shembuj çfarë ndryshon në kontekstin historik me zbulimin e dorëshkrimit të ri është edhe vendosja në rrethana krejt të tjera, pra jo të paqes por në rrethana të kundërta të kryengritjes që ka filluar në Arbëri. Këtë e ka përmendur edhe biografi i Barletit, Francesk Pali, i cili e vendos edhe ai në rrethanat e paqes por që shkruan më poshtë se mund të jetë shkruar edhe më përpara. Mendja igjenioze e Francesk Palit ka kuptuar edhe më përpara kur kishte shpërthyer kryengritje në Arbëri dhe signoria (Autoriteti politik suprem i republikës së Venedikut ishte një grup prej 10 të zgjedhurish, të cilët quheshin "Signoria", shprehje që me kalimin e kohës filloi të simbolizonte qeverinë e Venedikut) dërgoi Skënderbeun. Ai e jep të përmbysur situatën, se nuk ishte një kryengritje e provokuar nga Signoria por kryengritja kishte filluar në Lezhë dhe kishin 2 vjet që arbërit që kërkonin me këmbëngulje që të vinte nipi i Skënderbeut që ishte Skënderbeu i Ri".

## MARRËDHËNIA E BEÇIKEMIT ME BARLETI

Ndryshim tjetër me rëndësi që ndodh pas zbulimit të dorëshkrimit është marrëdhënia me Beçikemin. Duke e llogaritur marrëdhënien e botimit të Rrethimit të Shkodrës më 1504 me Panegjrikun e Beçikemit e vitit 1503. Është menduar gjithmonë që Barleti në një farë mënyre i kundërvihet Beçikemit. Madje ka edhe pjesë, apo pasazhe të marra nga Beçikemi. Është

përdorur argumenti thjesht i dative ngaqë është e saktë që, Panegjriku në fjalë, që lidhet me mbrojtjen e Shkodrës është saktësisht i botuar më 1503, ndaj 1504 e Barletit e ka bërë automatike këtë lloj marrëdhënie, e cila tashmë duhet të kthehet përmbys se nuk ka qenë Barleti që ka shkruar mbas Beçikemit dhe ka marrë Beçikemit, por duhet të ketë qenë një palë marrëdhënie krejt të tjera. Autorët që kanë bërë këtë shënim, kanë përmendur Palin. Në një farë mënyrë janë korrekt, kanë thënë tezën e tij, por do ishte mirë të kishin hyrë vetë në këtë ballafaqim, dhe ndoshta nuk do ishin nxituar të mbërrinin në këtë përfundim, i cili po të kisha përdorur shenjat grafike, tani do t'i vija një kryq, d.m.th. që bie poshtë. Teza e Palit është vërtetë e tillë, që flet se vepra e Beçikemit është botuar vetëm në vitin 1503 dhe Barleti i është përgjigjur Beçikemit, nuk ka qenë dakord me të, dhe është detyruar të vihet ai për të shkruar një vepër tjetër. Një lloj kundërvënies ndaj Beçikemit, çfarë tani me dorëshkrimin e gjetur të paktën vepra e 1501 bie poshtë.

Por, marrëdhënia e Beçikemit me Barleti, nganjëherë ka qenë edhe e ekzagjeruar në mënyrë të bukur dhe të besueshme. Edhe unë e kam besuar një tezë shumë interesante. Shikoni sa interesante është teza, e them pa ironi, ku te parathënia e Rrethimit të Shkodrës, prapë te Beçikemi, mundet që aludon ai, Barleti ndër të tjerë kur i thotë Dozhit, Lenardo Loredano: Kthjelltësia jote e ruajtë këtë vepër nga kafshimet e zemërkëqijve. Pra tregon se ka pasur armiq, rivalë Barleti.

"Në të vërtetë ne kemi arritur në përfundimin se një nga arsytet për të cilat Barleti e shkroi Rrethimin e Shkodrës, fill e flak pas botimit gjer në korrik të vitit 1503 të Panegjrikut, ku Beçikemi bëri historikun e atij rrethimi, duke ia kushtuar veprën të njëjtë sundimtar të Venedikut ka qenë që të vinte në vend, çka Beçikemi kishte vlerësuar jo sa duhet meritën e masës së Shkodranëve dhe të shqiptarëve. Dhe Barleti me inatin që e pushtoi

atëherë nuk ka përmendur asnjë Beçikem, midis të merituarve në rrethimin e famshëm. Barleti për-buzës, i ashpër, lavdidashës..." etj.. Teza pra është shumë interesante dhe tashmë bie poshtë se del Barleti e ka shkruar përpara Beçikemi. Tezën e kam pas pranuar edhe unë, kam shkruar për të me një farë rezerve, në një punim të botuar jashtë që them se rivalë ka pasur, që mundet të ketë qenë Beçikemi por kam rreshtuar edhe një numër autorësh të tjerë me të cilët mund të ketë qenë i detyruar të rivalizojnë Barletin. Të paktën, para dy vjetësh e kam shprehur dyshimin, që duhet të jemi të kujdesshëm me këtë rikonstrukcion dhe nuk kemi të drejtë të përjashtojmë mundësinë që Barleti mund të shkruar tekste të tjera të botuara apo jo, përpara këtyre veprave. Dyshimi është hedhur, që përpara këtyre dy veprave Barleti mund të ketë shkruar tekste të tjera, që mund të dalin edhe përtej veprës që flasim tani. Me shprehjen latine librat kanë fatin e tyre, në këtë rast për specialistët e Bibliotekës së Francës ku ndodhet dorëshkrimi, prejardhja është nga biblioteka Mazarine, që ishte kardinali i famshëm i mesit të shekullit XVI. Ai ishte koleksionist i sëmure për piktura, dhe të dorëshkrimeve, ishte organizator i një gjahu, që e niste për Itali në Gjermani në gjithë vendet e Europës për të kapur dorëshkrime, vepra etj., dhe për t'i bërë pronë të bibliotekës së vet. Në kohën kur ndodhej në Romë kishte 5 mijë burime, Biblioteka e tij kur u vendos në Paris, në 1640, përbën 14 mijë vëllime, një pjesë e tyre sot ndodhen në Bibliotekën Nationale të Francës, dhe kam shënuar se ky dorëshkrim do riprodhohet së afërmi për Bibliotekën tonë Kombëtare në Tiranë.

Verifikimi i prejardhjeve bëhej nga stemat, lidhjet e librave. Librat botoheshin në fashikuj, të lidhur me spango, që ishin për pasunikët, kontët mbretërit, dhe secili i lidhte me ngjyrën dhe sipas dëshirës, dhe stemën që donte ai. Stema ishte si vula e sotme, madje më e sigurt, se ajo e Bibliotekave të sotme që mund të falsifikohet./MAPO



# KOSOVA PRITET TË MERR REKOMANDIM POZITIV PËR VIZAT

Prishtinë, 26 qershor - Kosova ka gjasë të merr rekomandim pozitiv për vizat, por pengesë për këtë mund të jenë disa shtete të Zonës Shengen, përfshirë këtu edhe Spanjën. Kështu thuhet në raportin: "Rruga e gjatë e Kosovës për udhëtimin pa viza", të publikuar nga Grupi Ballkanik i Politikave, pak ditë para se Komisioni Evropian të nxjerrë rekomandimin për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Po behet një dekadë që kur heqja e vizave iu premtua qytetarëve të Kosovës, por megjithëkëtë kosovarët vazhdojnë të presin me muaj të tërë për t'u pajisur me viza.

Pikërisht për vizat, pak ditë para se Komisioni Evropian të nxjerrë rekomandimin për Kosovën, Grupit Ballkanik i Politikave, ka publikuar raportin: "Rruga e gjatë e Kosovës për udhëtimin pa viza", në të cilin flitet edhe për rekomandimin të cili vendi do të merr këto ditë.

Për këtë, për Radio Kosovën flet Naim Rashiti: "Në fund të këtij muaji ose në fillim të muajit tjetër do të ketë një rekomandim, besoj

Naim Rashiti: "Në fund të këtij muaji ose në fillim të muajit tjetër do të ketë një rekomandim, besoj pozitiv..."



pozitiv. Vonesat në raste të tilla nuk japin sinjale të mira, pasi që gjithmonë Komisioni Evropian, provon të konsultohet me shtetet anëtare, për dhënien e opinionit. Pra, nëse rekomandimi vonohet, mund të mos kemi lajme të mira", tha ai.

Sipas Rashitit, Kosova edhe nëse merr rekomandim pozitiv për vizat, mund të ketë pengesa. Ai përmend disa nga shtetet të cilat sipas tij kanë shpreh skeptici-

zem në lidhje me këtë proces.

"Franca është në tërësi skeptike ndaj zgjerimit. Belgjika po ashtu si Franca, ka problem me azilkërkues dhe Holanda e cila ka një qëndrim shumë radikal për zgjerimin, përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor", pohoi ai.

Sipas Rashitit pengesa mund të sjellë edhe Spanja, e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Drejtori i Grupit Ballkanik Politikave,

thekson se pritjet janë që në fund të këtij viti ose edhe në tre muajin e parë të vitit të ardhshëm të merret vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ai shton se nëse nuk ndodhë kështu, atëherë Kosova mund të mos merr liberalizimin e vizave edhe vitin e ardhshëm, pasi që në pranverën e vitit 2019, organizohen zgjedhjet për Parlamentin Evropian.

## Refugjatët iranianë, një torturë serbe në rrugën drejt Europës

Mes turmave të emigrantëve që nga Lindja rendin drejt Perëndimit, hasen edhe iranianë, ndonjë vendi i tyre nuk është përfshirë në ndonjë konflikt. Dhe ata po përdorin Serbinë si trampione drejt vendeve të BE-së, pasi Serbia në vitin 2017 hoqi vizat për qytetarët e Iranit, duke jua lehtësuar kështu ardhjen e tyre në Evropë.

Në një shkrim të REL thuhet se emigrantët që e enden nëpër parqet publike të Beogradit janë pre e kontrabandistëve. Ata thonë se këta të fundit u kërkojnë nga 4000 deri në 7000 euro, nganjëherë edhe 10,000 euro për t'i çuar drejt BE-së.

Njëri prej tyre dyshon se pas tyre qëndrojnë dhe qeveritarë, ose që ka një politikë qeveritare që jua vështirëson qëndrimin. Stevan Tataloviç nga një OJQ, ka thënë se në gjashtë muajt e fundit, në Serbi kanë arritur 6 mijë iranianët, por shumica e tyre ka vazhduar në vende të tjera.

"Në kampet që ka ngritur qeveria janë rreth 500 njerëz. Me shumicën prej tyre edhe abuzohet. Disa prej tyre janë duke u persekutuar për arsye politike. Disa prej tyre kanë qenë viktimat, sepse janë anëtarë të komunitetit LGBT", shpjegoi Tataloviç.

Një prej kampeve të ngritura nga qeveria serbe është dhe ai në Preshevë. Somaja dhe familja e saj udhëtuan drejt Serbisë të ikur nga qyteti iranian Karaja. Ajo i përshkroi kushtet e vështira në kamp duke folur për Radio Europa e Lirë.

"Është një dhomë është shumë i ftohtë për fëmijën tim 5 vjeç. Ne jetojmë mes miza, milingonave dhe buburrecave. Kemi ikur për një jetë më të mirë, por këtu ku jemi nuk kemi shpresë. Ky vend nuk është e mirë për jetën", tha ajo. Për Aliun, jeta e dëshpëruar në kampin e refugjatëve pasi ikën nga dhuna në Iran është e padurueshme.

"Në Iran donin të më prisnin veshin për një vath. Ndërsa policia më rrihte për tatuazhet. Prandaj u largova nga Irani", thotë ai, tashmë në një tjetër gjendje dëshpëruese.

Për ata që po largohen nga persekutimi, kthimi në Iran nuk është një opsion. Por ata ndihen dhe më të pasigurt në Serbi, me të ardhmen e tyre në një vend të huaj dhe jo aq miqësor.

## Thaçi e Vuçiqi takohen sërish pas 2 javësh

Takimi i radhës mes presidentëve të Kosovës dhe atij të Serbisë, Hashim Thaçi e Aleksandar Vuçiq, pritet të zhvillohet pas 2 javësh. Kështu kanë konfirmuar nga kabineti i presidentit serb Vuçiq për të përditshmen serbe "Blic". Vazhdimi i dialogut në një periudhë kaq të shkurtër mund të nënkuptojë edhe praktikisht intensifikim të procesit, për të cilin foli edhe shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini pas takimit të



së dielës në Bruksel, transmeton Koha.net. "Serbinë e pret ende punë, ka shumë çështje të hapura në tavolinë. Përfaqësuesit e

Evropës në mënyrë intensive do të vijjnë në Beograd, por edhe delegacioni serb do të udhëtojë në Bruksel më shumë se deri më tani. Ajo që dihet sigurt pas takimit të së dielës është se gjërat do të zgjidhen me një marrëveshje të përbashkët, me miratimin e të gjitha palëve, pëlqimi i të cilëve është i nevojshëm", thotë burimi i "Blicit". Në takimin e së dielës, Thaçi e Vuçiqi vazhduan bisedimet pas tre muajve pauzë.

## Rama prezanton llogarinë "MOS KINI FRIKË NGA SHQIPONJA"

"MOS KINI FRIKË NGA SHQIPONJA është emri i llogarisë bankare ku gjithkush mund të japë një kontribut simbolik, për të paguar gjobën absurde të FIFA-s ndaj Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit"

Tiranë, 26 qershor - Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama ka bërë të ditur se tani është hapur edhe një llogari bankare ku përmes saj, secili mund të japë një kontribut simbolik për të paguar gjobën e FIFA-s ndaj Granit Xhakës e Xherdan Shaqirit. "MOS KINI FRIKË NGA



SHQIPONJA" është emri i llogarisë në Raiffeisen Bank, ka thënë Rama, njofton Klan Kosova. "MOS KINI FRIKË NGA SHQIPONJA është emri i llogarisë bankare ku

gjithkush mund të japë një kontribut simbolik, për të paguar gjobën absurde të FIFA-s ndaj Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit". Rama ka theksuar se shenja dal-

luese shqiptare e komunikimit është keqinterpretuar duke u konsideruar provokim, derisa ka shpalosur detaje dhe rreth arsyes së hapjes së kësaj llogarie, njofton Klan Kosova. "Shenja e duarve shqiptonjë është shenja jonë dalluese e komunikimit në raste gëzimi dhe me keqardhje për ata që e keqinterpretuan shenjën e gëzimit krejt spontan nga një moment i bukur sportiv, në Raiffeisen Bank është hapur llogaria MOS KINI FRIKË NGA SHQIPONJA

Kjo llogari u hap falë nxitjes së shumë miqve të këtij rrjeti social nga e gjithë bota, si falenderim e mirënjohje për dy sportistët që ngritën peshë në një gëzim sportiv miliona shqiptarë".



# LIBIA REFUZON KAMPET E REFUGJATËVE



Në një konferencë të përbashkët shtypi me ministrin e Punëve të Brendshme të Italisë, Matteo Salvini në Tripoli, zëvendëskryeministri i Libisë, Ahmed Meitik u shpreh se është i gatshëm të bashkëpunojë me Bashkimin Europian në çështjen e migracionit ilegal. Por Libia e refuzoi "kategorikisht" që qendra të tilla të ngrihen në territorin e saj. Kjo do të shkelte ligjin libian.

Ministri i Punëve të Brendshme të Italisë, Matteo Salvini ishte shprehur më parë për ngritjen e kampeve pritëse për refugjatët në 5 vende afrikane, por pa përmendur

emra konkretë. Në kthim në Itali ai u shpreh pastaj konkretisht për ngritjen e kampeve të tilla në jug të Libisë, Niger, Mali, Çad dhe Sudan. Qendra të tilla pritëse dhe identifikimi do të ndihmojnë Italinë si Libinë, të "ndalë" migracionin, kështu është shprehur kreu i partisë armiqësore ndaj të huajve, Lega. Si shpërblim këto vende do të marrin më shumë ndihma për zhvillim. Për këtë ai do të këmbëngulë edhe në samitin e BE-së në Bruksel më 28 e 29 Qershor.

Në BE diskutohet me zjarr për politikën ndaj refugjatëve. Në ditët

e shkuara ka pasur propozime nga më të ndryshmet për migracionin. Franca dhe Spanja janë shprehur për ngritjen e kampeve të mbyllura në territorin e BE-së. Salvini e hodhi poshtë këtë plan. Hotspot-et për regjistrimin e refugjatëve në Itali nuk janë zgjidhja e problemit, sepse nuk e ndërpresin fluksin përmes Mesdheut. Edhe Austria dhe Danimarka duan qendra azili jashtë Europës.

I pasqaruar është kuadri ligjor për ngritjen e qendrave të tilla të mundshme jashtë BE. Komisioni Europian është shprehur, se qen-

drat e azilit nuk duhet të jenë ligjërisht "vrime të zeza". Prandaj edhe azilkërkuesit e mbërritur ndërkohë në BE nuk duhet të kthehen në kampe jashtë BE. "Qendrat e zbarkimit" të këtij lloji nuk janë në ujdi me të drejtën ndërkombëtare, u shpreh një zëdhënëse të hënën në Bruksel.

Libia është porta kryesore për refugjatët nga vendet afrikane që përmes Mesdheut duan të hyjnë në BE. Sipas disa llogaritjeve qindra mijëra vetë presin në Libi për shansin e hyrjes në Europë. Organizatat humanitare kritikojnë trajtimin jo adekuat të këtyre migrantëve në kampet libiane.

Qeveria nacional-populiste në Romë ka mbyllur portet italiane për refugjatët e shpëtuar në Mesdhe që duan të zbarkojnë në tokë. Qëllimi i saj është që refugjatët që shpëtohen nga roja bregdetare italiane të kthehen me anije në Libi. Roja bregdetare italiane i kalon tani sinjalët e emergjencës të lëshuara nga gomonet në rrezik tek roja bregdetare libiane. Bllokada italiane ka bërë që prej ditësh qindra afrikanë të ngujohen në anijet e organizatave humanitare dhe anijet e mallrave që kanë marrë në bord njerëzit në rrezik mbytjeje.



## Tërhiqet Trump, s'ka ndjekje penale për emigrantët në kufi

Administrata e Donald Trump bën një tjetër hap prapa duke vendosur të tërhiqet deri diku nga politika e tolerancës zero në kufi.

Komisionieri i mbrojtjes kufitare dhe doganave, Kevin McAleenan sqaroi se ndjekja penale e emigrantëve që kalojnë ilegalisht kufirin për të hyrë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është pezulluar përkohësisht. Në këtë mënyrë, siç thotë ai, thjesht u zbatua urdhri i dhënë javën e kaluar nga shefi i Shtëpisë së Bardhë për fundin e ndarjes së familjeve, një fenomen ky që ka shkaktuar polemika të mëdha si brenda Shteteve të Bashkuara, ashtu edhe jashtë tyre.

Por ajo që Trump në fakt sugjeronte ishte që familjet të ndalohej në bashku. Presidenti republikan iu dorëzua presionit publik të mërkurën kur firmosi urdhrin ekzekutiv, i cili i mban familjet bashkë në qendrat e emigrantëve.

McAleenan thotë se taktikat e tolerancës zero vazhdojnë të mbeten në fuqi, por sipas BBC-së, udhëzimet e tij ndaj agjenteve kanë krijuar një lloj përshtjellimi.

Sipas kësaj praktike, prindërit nuk mund të ndiqen penalisht nëse janë të shoqëruar me fëmijë dhe zyrtaret amerikane nuk kanë më ndërmend ti ndajnë. Kjo do të thotë se agjentët kufitare që ndalojnë emigrantët të rritur pa dokumente të shoqëruar nga të mitur, do t'i dorëzojnë një fletë që dëshmon shkeljen e do t'i lënë të largohen në punën e tyre në vend që t'i mbajnë në qendrat e ndalimit.

## Furgoni godet selinë e gazetës më të madhe holandeze

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të kësaj të marte, ku një furgon ka goditur hyrjes kryesore të ndërtesës ku ndodhet gazeta më e madhe holandeze në Amsterdam, "De Telegraaf", e cila e ka quajtur një akt të qëllimshëm. Sipas policisë holandeze, bëhet fjalë për një "akt të qëllimshëm". "Nuk do të na frikësojnë", – ka shkruar "De Telegraaf", duke konfirmuar që asnjë persona nuk është lënduar. Që në të shkuarën, gazeta kishte marrë

kërcënime të ndryshme. Forcat e rendit po kërkojnë drejtuesin e mjetit, i cili dyshohet se është larguar në bodin e një makine "Audi" të drejtuar një person tjetër. "Ky akt i qëllimshëm kundër 'de Telegraaf'-it, është një goditje ndaj lirisë së shtypit dhe demokracisë holandeze. Ka akoma zona të errëta, por ne do të qëndrojmë vigjilentë dhe policia po bën gjithçka për të ndaluar autorët", – ka shkruar në "Twitter" kryeministri holandez Mark Rutte.



## MERKEL: Samiti i BE-së nuk do të zgjidhë çështjen e emigrantëve



Berlin, 26 qershor - Kancelarja gjermane, Angela Merkel deklaroi sot se zgjidhja për çështjen për emigrantët në nivel evropian nuk do të arrihet në samitin e ardhshëm të liderëve të BE-së, por ajo do të vazhdojë të kërkojë marrëveshje bilaterale.

"Nuk do të ketë zgjidhje për gjithë paketën për azilkërkuesit për të gjitha shtatë direktivat deri të premtën", tha Merkel në konferencën e përbashkët me kryemi-

nistrin spanjoll, Pedro Sançes duke shtuar se nevojitet më shumë kohë të punohet në dy direktivat. "Për këtë shkak kam biseduar për punën me shtetet të cilat dëshirojnë të punojnë në të gjitha dimensionet e politikës së emigrantëve, kryeministri spanjoll foli për dimensionin e jashtëm, ndërsa unë kam folur për dimensionin e brendshëm dhe në këtë frymë edhe më tej kemi bisedime ditëve në vijim", deklaroi Merkel. (MIA)

# CELULARI SHKAKTON NDRYSHIME NË METABOLIZMIN E TRURIT

Ne jeten tonë të përditshme, ne ndeshemi me vale të shumëllojeshme, ndaj të cilave organizmi reagon në menyra të ndryshme. Ato më të dëmshmet, përfshijnë valët e prodhuara artificialisht si nga stacionet e radios, televizoret, telefonat celularë, kompjuterat dhe të tjera. Të gjitha këto vale transmetojnë energji secila në masë më të madhe apo më të vogël. Efekti i tyre mbi organizmin është i ndryshëm (sepse janë vale me karakteristika të ndryshme).

E gjitha kjo është një ndotje e "padukshme", "nuk ka erë", por që shkakton rrezatim elektromagnetik vecanerisht të rëndë dhe të demshëm, duke rrezikuar për tumore, sidomos tek femijet. Studimet e viteve të fundit kanë vënë në dukje se valet e padukshme të spektrit elektromagnetik, kanë një ndikim të thellë mbi mbi cdo aspekt të rregullimit biologjik. Funkcionet biologjike të organizmit tone (te rrahurat e zemrës,



funkcionimi i trurit, reaksionet metabolike që ndodhin në cdo qelizë, etj), rregullohen nga rrymat, pra ne jemi "qenie elektrike" shkruan dr. Viktor Qereshniku.

Hulumtuesit në Institutin Kombëtar për Shëndetësi kanë

zbuluar se thjeshtë, vetëm mbajtja e një celulari aktiv afër kokës për 50 minuta, prodhon ndryshime të dukshme në metabolizmin e trurit. Lexoni me poshtë se çfarë duhet të bëni për të mbrojtur veten nga ky rrezatim i dëmshëm.

- Të mos mbahet telefoni celular afër, nën jastëk, gjatë gjumit.

- Të shkurtohet koha dhe numri i telefonatave që ben duke përdorur telefonin celular.

- Të përdoren kufjet, sepse

edhe me disa centimetra distancë, fusha elektromagnetike bie dukshëm në intensitet.

- Të mbahet celulari sa më larg nga koka që është e mundur. Shkruaj (SMS mesazhe) ose përdor altoparlantin e celularit sa më shpesh.

- Në shtëpi të përdoren telefonat me tela të modes së vjetër, në vend të atyre bashkohore pa tela.

- Të mbahet laptopi larg nga preheri, të vendoset në tavolinë.

- Të largohen të gjitha, apo shumica e pajisjeve elektrike nga dhoma e fjetjes.

- Të konsumohen super-ushqime dhe suplementare antioksidues, për të luftuar radikalet e lira që valet elektromagnetike krijojnë.

- Të përdoret teknologji tokëzimi për të stabilizuar ritmet elektrike të trupit dhe minimizuar efektet e interferencës së frekuencave elektromagnetike.

## Where People Can't Live Without The Internet

Share of respondents who can't imagine life without the internet



## Në cilat vende qytetarët nuk jetojnë dot pa internet?

E keni menduar ndonjëherë si do të ishte jeta juaj pa internetin? Duke pasur në konsideratë volumin e kohës që njerëzit shpenzojnë në telefonët, iPad-ët dhe laptopët e tyre, një jetë pa internetin vështirë të imagjinohet këto ditë.

Për shumicën e njerëzve, koha përpara se të mbërrinte World Wide Web (WWW) është thjesht një kujtim e cila ka filluar të venitet nga impakti që ka pasur teknologjia tek jeta e njeriut.

Hulumtuesit e Ipsos kanë zbuluar se shoqëritë në tërësi nuk mund të jetojnë pa internet. Nga 18,180 të anketuar në 23 shtete, Ipsos arriti në përfundimin se 2/3 e tyre nuk mund të imagjinonin jetën pa web-in.

Në Indi 82% e njerëzve nuk e mendojnë një jetë pa internet ndërsa në Itali dhe Japoni vetëm 62%.

## Temat më të kërkua në Google për vitin 2017

Domain më i njohur i internetit publik bilancin e tij për vitin 2017, temat më të njohura janë uragani Irma e ndjekur nga dy smartfonët e Apple-it. Më pas vijonë personazhet më popullore, njëri për anën e tij negative, Matt Lauer një nga të famshmit e akuzuar për përdhunim dhe abuzime seksuale në SHBA dhe tjetra është Meghan Markle, e fejuara e princit Herri.

Listimi i personave varion që nga të akuzuarit për abuzime, Matt Lauer deri tek Harvey Weinstein, Meghan Markle e dyta, ndërsa Melania Trump renditet e shtata dhe Floyd Mayweather në vendin e tetë, sportisti më i pëlqyer.

Persona: 1) Matt Lauer 2) Meghan Markle 3) Nadia Toffa 4) Harvey Weinstein 5) Kevin Spacey 6) Gal Gadot 7) Melania Trump 8) Floyd Mayweather 9) Michael Flynn 10) Philippe Coutinho

Përveç uraganëve, boomi i bitcoin-it tërhoqi vëmendjen e lajmeve së bashku me sulmin në një festival në Las Vegas, pjesërisht politika, Koreja e Veriut është më e kërkua.

Lajme: 1) Uragani Irma 2) Bitcoin 3) Sulmi i Las Vegasit 4) Koreja e Veriut 5) Eklipsi diellor 6) Uragani Harvey 7) Manchester (sulmi në koncertin e Ariana Grande-s) 8) Uragani Jose 9) Uragani Maria 10) Gjirafa April

Fejesa e Meghan Markle me princin



Herri e nxori në vend të parë të listës së aktorëve duke zëvendësuar Kevin Spacey.

–Aktorë: 1) Meghan Markle 2) Kevin Spacey 3) Gal Gadot 4) Louis C.K. 5) Bill Skarsgård 6) Millie Bobby Brown 7) Tom Holland 8) Kaley Cuoco 9) Saoirse Ronan

–Teknologjia: 1) iPhone 8 2) iPhone X 3) Nintendo Switch 4) Samsung Galaxy S8 5) Xbox One X 6) Nokia 3310 7) Razer Phone 8) Oppo F5 9) OnePlus 5 10) Nokia 6

Zgjedhjet: 1) Francë 2) Gjermani 3) Mbretëri e Bashkuar 4) Uttar Pradesh 5) Zgjedhje në Gjeorgji 6) Zgjedhje në Montana 7) Zgjedhje në British Columbia 8) BMC 9) Zgjedhje rajonale në Sicili 10) Holandë

Ngjarje sportive: 1) Wimbledon 2)

Super Bowl 3) Mayweather vs McGregor 4) Tour de France 5) Botërori i bejsbollit 6) Australian Open 7) US Open 8) Kupa e konfederatës së FIFA-s 9) Playoffs i NBA 10) UEFA Champions League

Vdekjet: 1) Tom Petty 2) Chester Bennington 3) Chris Cornell 4) Bill Paxton 5) Hugh Hefner 6) Aaron Hernandez 7) Lil Peep 8) Mao Kobayashi 9) Charlie Murphy 10) David Cassidy Seriale dhe shows të TV 1) Stranger Things 2) 13 Reasons Why 3) Big Brother Brasil 4) Game of Thrones 5) Iron Fist 6) Big Boss 7) Riverdale 8) American Gods 9) The Kapil Sharma Show 10) Mindhunter

Receta: 1) Gjoks pule 2) Mish i grirë 3) Pogaça (bukë turke) 4) Tost francez 5) Kek tarifi (tortë) 6) Kofshë derri 7) Spagheti me kungull 8) sallatë me lakër 9) Pesto 10) 麩后 (brumë për ushqim japonez)

“Vërtet ndjehem mirë që jam pjesë e këtij klubi. Ajo që më detyroi të bëhem pjesë e kësaj skuadre ishte fakti që nga momenti kur kemi biseduar me kryesinë, më treguan se kanë projekt të ri dhe disa qëllime, që vërtet më pëlqyen dhe jam i lumtur që do të jem pjesë e këtij projekti”, pohon Aleksovski

Shkup, 26 qershor - Skuadra e FC Shkupit vazhdon më afrimin e lojtarëve të rinj, në prag të sezonit të ri në Ligën e Parë Futbollistike edhe garës në Liga Evropa. Pas arritjes së marrëveshjes me Muarem Muarem, Amir Bilalin dhe Artan Veliun, anëtar më i ri i FC Shkupit është portieri Igor Aleksovski. 23-vjeçari, vjen nga skuadra e Vardarit, ku ishte pjesë e “kuqezinjve” në dy vitet e fundit, ndërsa më parë ishte pjesë e skuadrës së Makedonija Gjorçe Petrov, ku kaloi të gjitha kategoritë, për të arritur edhe deri te ajo seniore. Aleksovski dje iu bashkua ekipit në përgatitjet në Turqi ku edhe kishte prezantimin zyrtar me fanellën e tij të re, ndërsa tha se ndjehet mirë që është pjesë e këtij klubi, ndërsa vendimtare për ardhjen e tij te Shkupi ka qenë projekti i kryesisë së klubit të cilat Aleksovskit i kanë pëlqyer shumë. “Vërtet ndjehem mirë që jam pjesë e këtij klubi. Ajo që më detyroi të bëhem pjesë e kësaj skuadre ishte fakti që nga momenti kur kemi biseduar me kryesinë, më treguan se kanë projekt të ri dhe disa qëllime, që vërtet më pëlqyen dhe jam i lumtur që do të jem pjesë e këtij projekti. Porosia për tifozët e Shkupit është që të vijnë ashtu sikurse kanë ardhur deri më tani në numër të madh, të na përkrahin

IGOR ALEKSOVSKI, PORTIERI I RI I FC SHKUPI

## GJITHMONË KAM PAS DËSHIRË QË TË LUAJË PARA NJË TIFOZERIE TË TILLË



ashtu sikurse e kanë bërë në çdo ndeshje dhe vërtet kam pas dëshirë që të luajë para një tifozerie të tillë. Pritja ka qenë e mrekullueshme, pasi që me disa futbollistë edhe jemi njohur më parë, me të tjerët u

njoftuam dhe më pranuan mirë duke më dëshiruar sukses që së bashku ti arrijmë qëllimet tona”, deklaroi Aleksovski. Ndryshe, Në karrierën e tij dallohen mbrojtjet fantastike për përfaqësuesen e Ma-

qedonisë U21, me të cilën siguroi kualifikimin historik në Kampionatin Evropian U21 në Poloni. Vitin e kaluar Aleksovski kaloi 990 minuta në portën e Vardarit, ndërsa ishte edhe pjesë e përfaqësueses së Maqedonisë në eliminatorët e Botërorit “Rusi 2018”, në sfidën Spanjë–Maqedoni (4-0). Kontrata e Aleksovskit me Shkupin do të zgjatë për dy vite me mundësi për të vazhduar edhe një tjetër. Aleksovski do të shtojë konkurrencën në portën e FC Shkupit dhe do të jetë zëvendësim për Burhan Mustafan, që u largua pas përfundimit të sezonit që lamë pas.

### LEVADIA DHE ÇELIK, DY TESTET E RADHËS

Pas ndeshjes së parë kontrolluese në Bollu kundër Neftçit, FC Shkupi do të zhvillojë edhe dy ndeshje miqësore. Të mërkurën bardhekaltërit do të luajnë kundër Levadisë nga Estonia, ndërsa një ditë më pas do të takohet me skuadrën e Çelik nga Bosnja. Agjencia për aranzhimin e ndeshjeve miqësore në koordinim me stafin teknik të FC Shkupit dhe trajnerin Zekirja Ramadani, kanë konfirmuar se planifikohet edhe një ndeshje tjetër miqësore më 2 korrik, një ditë para kthimit të ekspeditës së FC Shkupit në vendlindje.



### Ajeti drejt kampionatit francez

Arlind Ajeti është ende një futbollist i Torinos, por skuadra italiane nuk e ka në plane. Pasi Krotone nuk e shfrytëzoi klauzolën për të blerë kartonin e tij, shqiptari duhet të gjejë një skuadër, duke qenë se skuadra e Maxarrit nuk e ka në plane për fazën përgatitore në Filadelfia. Së fundmi, mediat pranë skuadrës torinese bëjnë me dije se Nimes në Francë është skuadra, me të cilën agjenti i mbrojtësit të Kombëtares ka nisur bisedimet. Nga sa bëhet me dije, për Ajetin skuadra franceze është e gatshme që të ofrojë një kontratë dyvjeçare. Ndonëse kontaktet janë të avancuara, nuk bëhet ende fjalë për firmë. Së pari, Torino duket e gatshme që ta lërë të lirë shqiptarin dhe do të ishte e kënaqur vetëm të heqë dorë për pagën e tij mujore. Ky është edhe problemi i vetëm me ekipin francez, pasi është i gatshëm të ofrojë vetëm 200 mijë euro pagë vjetore. Në krahasim me pagën e saktësuar në kontratë me Torinon, diferenca është 50 mijë euro, e cila përbën edhe pengesën e momentit mes palëve.

## Strakosha “i pashitshëm”

Toma Strakosha është kthyer në një pikë referimi te Lacio, duke mbrojtur kuadratin e portës në 53 ndeshje nga 55 që Lacio ka zhvilluar në total sezonin që lamë pas. Për të interes të lartë ka nga Liverpooli por edhe Bajern Leverkusen në Gjermani qëndron pas tij. Siç raportohet nga “Corriere dello Sport”, Strakosha i detyrohet gjithçka Tares dhe Lotitos, të cilët i besuan atij pavarë-

sisht se zhvilloi sezon negative në huazimin te Salernitana. Rrugët e merkatos janë të pafundme por gjithçka do të vendoset javën e ardhshme. Por, Lacio nuk e ka nxjerrë në treg “gardianin” kuqez, duke iu mbyllur derën ekepeve të tjera. Sidoqoftë për siguri Tare ka siguruar marrëveshjen me portierin Silvio Proto, që me shumë mundësi do jetë portieri i dytë në sezonin e ardhshëm.



EMRAN RAMADANI LARGOHET NGA PARTIZANI

## U largova prej tre trajnerëve intrigantë

Shkup, 26 qershor - Emran Ramadani largohet nga skuadra e Partizanit vetëm pas gjashtë muajve qëndrim. Ish-futbollisti i Renovës zhvilloi vetëm gjashtë ndeshje në të gjitha si zëvendësues dhe shënoi një gol. Dje ka marrë fund aventura e tij me të kuqtë, gjë e cila u konfirmua nga lojtari dhe Partizani. “Klubi njofton përfundimin e bashkëpunimit me Emran Ramadani. Palët vendosën sot (dje) të ndërpresin me mirëkuptim kontratën mes tyre dhe mesfushori 26-vjeçar nuk do të vijojë të jetë pjesë e 15 herë kampionëve të vendit. Klubi falënderon Emran Ramadani për kontributin e dhënë te Partizani, duke i uruar njëkohësisht suksese në karrierë”, thuhet në njoftimin e klubit. Por, në një prononcim për “Panorama Sport”, lojtari tetovar tregon edhe

arsyen që e detyruan të largohet. Ramadani fajin ua vë të tre trajnerëve që ka punuar gjatë kësaj periudhe, Starova, Dalipi dhe Gega, të cilët i quan intrigantë dhe atë që mendonin nuk ua thoshin në sy, por merreshin me thashetheme. “Tashmë është zyrtarë që unë nuk do të jem më pjesë e Partizanit. Më vjen keq që gjërat rrodhën në këtë mënyrë, pasi respekti im mbetet maksimal për klubin dhe drejtuesit. Por, shkak për këtë largim janë trajnerët, me të cilët kam punuar gjatë kësaj periudhe, duke filluar nga Starova, Dalipi dhe së fundmi, Gega”, deklaroi Ramadani. Kështu, Ramadani i është bashkuar grupit të të larguarve, pasi më herët u larguan Batha, Kotobelli dhe Fejzullahi. Ndërkohë, skuadra ka disa ditë që përgatitjet verore dhe ato për eli-




minatorët e Liga Evropës, është duke i zhvilluar në qendrën përgatitore në Ohër. Cekim, më 12 korrik, Partizani do të përballet me Mariborin. Sa i përket afrimeve shumë emra qarkullojnë te Partizani por deri më tani asgjë konkrete nuk është parë.

OFERTA E ROKO KOMMISSOS PËR MILANIN

# 500 MILIONË PLUS NJË PJESË E BORXHIT ME "ELLIOTT"

Propozimi, siç raportohet nga "Sky", do të ishte shumë i rëndësishëm dhe do të arrijnë në 500 milionë euro, më shumë se një pjesë e madhe e borxhit të akumuluar me Fondin e "Elliott", e cila në total është 380 milionë euro (përfshirë edhe interesin). Për më tepër, siç shpjegohet nga "Corriere della Sera", manjati i sipërcituar ka vënë në pjetë edhe 32 milionë euro kapitale, plus 100 milionë të tjera për merkaton dhe shpenzime të tjera



Ka lajme të rëndësishme për të ardhmen e Milanit. Ekspedita kuqezi në SHBA, e udhëhequr nga Han Li, sipas "Sky Sports", po rezultojnë të suksesshme. Ai po kthehet në Itali mbas kontakteve pozitive me sipërmarrësin italo-amerikan, Roko Kommissos, të cilit i është ofruar blerja e klubit kuqezi. Propozimi, siç raportohet nga "Sky", do të ishte shumë i rëndësishëm dhe do të arrijnë

në 500 milionë euro, më shumë se një pjesë e madhe e borxhit të akumuluar me Fondin e "Elliott", e cila në total është 380 milionë euro (përfshirë edhe interesin). Për më tepër, siç shpjegohet nga "Corriere della Sera", manjati i sipërcituar ka vënë në pjetë edhe 32 milionë euro kapitale, plus 100 milionë të tjera për merkaton dhe shpenzime të tjera. Pronari i "New York Cosmos" mendon ta arrijë marrëveshjen me disa hapa. Së pari nuk do të marrë pjesë në një ankand të mundshëm; së dyti synon të mbyllë marrëveshjen këtë javë, pa prituri hapat e kuqezinjtë kinezë, me në sfond "Elliott". "Gazzetta dello Sport" flet për 48 orë të dhëna Yonghong Li për të pranuar ofertën. Kjo është për shkak se Kommissos nuk do të besojë tek Elliott. Vendimi i tmerrshëm i UEFA-s duhet të arrihet të martën, ose të mërkurën e kaluar, por ditët e ardhshme mund të shkruajnë një kapitull të ri në historinë e Milanit.

## Pastore, zëvendësuesi i Nainggolanit

Kur kanë kaluar vetëm disa orë që nga largimi i Radja Nainggolan drejt Interit, te Roma kanë gjetur menjëherë zëvendësuesin. Bëhet fjalë për Havier Pastoren, fantazistin argjentinas të PSZH-së, që dje ka mbërritur në kryeqytetin italian dhe është prituri nga dhjetëra tifozë në aeroportin e Fiumicino. "Çfarë entuziazmi i jashtëzakonshëm. Jam shumë i lumtur. Forca Roma", ishin fjalët e para të Pastores, pasi zbarkoi për herë të dytë në Serinë A. Fantazisti argjentinas do të kryejë sot (e enjte) paradite vizitat mjekësore me kryeqytetasit, për të hedhur më pas firmën mbi kontratë dhe për të bërë prezantimin zyrtar. Ky është një rikthim për Havier Pastoren në Serinë A, kampionat ku edhe spikati me Palermon, përpara se të transferohej te gjigantët francezë.



Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Teksti i pastruar) ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15 dhe 27/16), nenit 7 paragrafi 1 alineja 4 e Vendimit për themelimin e Qendrës për zhvillim të Rajonit planor lindor, ndërsa në pajtim me Vendimin nr. 04-222/1 të datës 26.06.2018, Qendra për zhvillim të Rajonit planor lindor, publikon

**SHPLLJE**

**Për punësim të Koordinatorit për veprimtari normative, furnizime publike, punë financiare dhe të përgjithshme në Qendrën për zhvillim të Rajonit planor lindor – 1 realizues për kohë të pacaktuar**

Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune (të jetë shtetas i R. Maqedonisë, të jetë i moshës së rritur, të mos i jetë shqiptuar dënim – ndalesë për kryerje të profesionit, detyrës ose veprimtarisë) kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- PSP – Fakulteti juridik VII / 1 (240 EKTS kredi)
- Përvojë pune: Me së paku 2 vjet përvojë pune
- Njohja e punës me kompjuter
- Njohje aktive të gjuhës angleze/ose gjuhë tjetër të huaj
- Përkushtim në punë dhe gatishmëri për punë nën presion
- Aftësi të mira organizuese
- Komunikim efikas me gojë dhe me shkrim
- Aftësi për punë ekipore
- Aftësi të shkëlqyeshme interpersonale dhe orientuese
- Aftësi për zgjidhje të konflikteve
- Vërtetim për dhënie të provimit për furnizime publike (në pajtim me Programin për edukim për furnizime publike – Modul për trajnim të organeve kontraktuese)

Përparësi kanë kandidatët me përvojë pune në furnizime publike. Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, duke konsideruar edhe ditën e publikimit. Punëdhënësi do të bëjë zgjedhjen në afat prej 21 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje, nga kandidatët të cilët i përmbushin kushtet e shpalljes. Kandidatët e interesuar të dorëzojnë dokumente me të cilat do të dëshmojnë se i plotësojnë kushtet e theksuara në shpallje së bashku me një Letër motivimi për punë dhe CV.

Orët javore të punës: 40; Orari i punës prej ora 08:00 deri në ora 16:00; Ditët e punës: prej ditës së hënë deri në ditën e premte.

Neto pagesa bazë: 30.000,00 denarë

Fletëparaqitjet për punësim së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri në: Qendrën për zhvillim të Rajonit planor lindor – Shtip, rr. "Vanço Prçe" nr. 119, kati 2, 2000 Shtip.

Qendra për zhvillim të Rajonit planor lindor  
Udhëheqës  
Dragica Zdraveva

**REPUBLIKA E MAQEDONISË**  
**MINISTRIA E FINANCËVE**  
**DREJTORIA DOGANORE**

**DREJTORIA DOGANORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**  
**LAJMËRON**  
se  
thirrja publike nr. 4/18  
për grumbullimin e ofertave për lidhje të marrëveshjes për shfrytëzim të hapësirës së punës për organin doganor në vijim:

1. Njësia doganore Strumicë 4050 hapësira e punës për import dhe eksport – terminal) të publikuar në gazetën ditore KOHA më datë 26.06.2018

**ANULOHET**

Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 89 të Statutit të Shkollës së mesme të Qytetit të Shkupit Rade Jovčevski – Korçagin – Shkup, ndërsa në pajtim me dispozitat nga neni 89-a, paragrafi (1), alineja (5) e Ligjit për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17, 64/18), Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur më datë 25.06.2018, ka sjellë vendim për publikim të shpalljes për anulim të shpalljes për zgjedhje të drejtorit të publikuar më datë 14.06.2018 me tekstin në vijim:

**SHPLLJE**

Për anulim të shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit

Anulohet shpallja publike për zgjedhje të drejtorit të Shkollës, të publikuar më datë 14.06.2018, për shkak të mospërputhjes së tekstit të shpalljes me nenin 1 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për arsim të mesëm të publikuar në Gazetën Zyrtare të RM nr. 64/2018. Ndryshimet e ligjit kanë të bëjnë me nenin 91 paragrafi 2 i Ligjit për arsim të mesëm.

Kryetar i këshillit të shkollës  
m-r Mitra Blazhevskia

Në bazë të nenit 22 dhe 23 paragrafi 1 i Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/2016) nenit 28 të Ligjit për kulturë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 187/2013, 44/2014, 61/15, 154/15, 39/16, dhe 11/18) dhe nenit 14 dhe 15 të Statutit të Institucionit komunal Shtëpia e kulturës "Dragi Tozija" Resnjë, Kryetari i Komunës së Resnjës publikon

**SHPLLJE PUBLIKE**

Për zgjedhje të drejtorit të Institucionit komunal Shtëpia e kulturës "Dragi Tozija" Resnjë

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

1. Të ketë të fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit sipëror nga sfera e shkencave shoqërore, humanistike ose matematiko-natyrore
2. Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune
3. Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
4. Të ketë një nga certifikatat e njohura ndërkombëtare në vijim ose certifikatë për njohje të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet më së voni në afat prej 1 viti nga emërimi i tij:
  - TOEFEL IBT – së paku 74 pikë,
  - IELTS – së paku 6 pikë,
  - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
  - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
  - BULATS – së paku 60 pikë ose
  - APTIS – së paku niveli B2.

Së bashku me fletëparaqitjet kandidatët duhet të paraqesin:

- Diplomë për arsim të mbaruar
- Vërtetim për përvojën e punës
- Certifikatë se nuk është i dënuar
- Certifikatë të shtetësisë
- Program për punën dhe zhvillimin e Institucionit komunal

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të paraqiten deri te Komisioni për shqyrtim të dokumenteve të arritura për zgjedhje të drejtorit pranë Shtëpisë së kulturës "Dragi Tozija" Resnjë. Shpallja publike zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së propozimit të kandidatëve.

Kryetari i Komunës së Resnjës  
Zhivko Gosharevski

**URGJENTISHT**

**Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221**

# PENALLTIA E RONALDOS THEU REKORDIN E KUPËS SË BOTËS



Portieri Ali Beiranvand ia mohoi numrit 7 të Portugalisë golin e tij të pestë në këtë Botëror. Nga këto penallti, 14 janë konvertuar në gol, 5 të tjera janë pritur nga portierët, ose e kanë humbur objektivin. Tetë nga vendimet për penallti, për më tepër, janë marrë pas konsultimit me VAR, një eksperiencë e re në këto finale

ekzekutimit të një penalltie në grupin B, kundër Iranit, të cilën e humbi. Ky 11-metërsheu rekordin, si i 19-të i finaleve të "Rusia 2018". Portieri Ali Beiranvand ia mohoi numrit 7 të Portugalisë golin e tij të pestë në këtë Botëror. Nga këto penallti, 14 janë konvertuar në gol, 5 të tjera janë pritur nga portierët, ose e kanë humbur objektivin. Tetë nga vendimet për penallti, për më tepër, janë marrë pas konsultimit me VAR, një eksperiencë e re në këto finale. Anglia, Australia dhe Arabia Saudite kanë marrë nga dy penallti në turneun e deritashëm, me Harry Kin dhe Mile Jedinak, lojtarët më pjellorë nga pika e bardhë, duke i konvertuar në gola dy penalltitë e tyre.

Ka qenë një Kupë Botërore e ngarkuar për të dyja palët, gjyqtarët në fushën e blertë dhe ndihmësit e tyre të VAR-it, deri më tani. Në bashkëpunim midis tyre, ato kanë vendosur një pikë referimi të re në krenimin ndërkombëtar të futbollit. Futbolli i "Rusia 2018" ka qenë i dukshëm për një numër të jashtëzakonshëm të penalltive të

dhëna, në shkallën e më shumë se një të tille për çdo dy ndeshje, deri më tani. Dhe ndërsa ne jemi ende në raundin e parë, ndeshjet në grupe, është bërë një pjesë e re e historisë së futbollit. Të hënën, në grupin A, portieri 45-vjeçar i Egjiptit, El Hadary, ia priti penalltinë Fahad Al-Muvallad të Arabisë Saudite. Vetëm pak minuta më vonë, megjithatë,

një penallti e dytë i është dhënë Arabisë Saudite, kësaj radhe u konvertua në gol nga Salman Al Faraj. Kjo ishte penalltia e 18-të e akorduar deri më tani në finalet e këtij Botërori, duke barazuar rekordin e një Kupe të Botës në këtë drejtim, edhe pse është konsumuar vetëm gjysma e rrugës. Orë më vonë, Cristiano Ronaldos iu dha mundësia e



## Fitorja ndaj Polonisë i dedikohet Sançezit

Trajneri i Kolumbisë Huse Pekerman ia ka dedikuar fitoren e mbrëmje së djeshme ndaj Polonisë lojtari Karlos Sançez i cili u ndëshkua me karton të kuq në minutën e tretë përballë Japonisë. Kolumbiani u kërcënua me vdekje për kartonin që mori dhe kjo është një gjë serioze. Policët po hetojnë mbi kërcënimet, të cilat u dërguan përmes rrjeteve sociale. "Ai ka kaluar një kohë të vështirë. Ne duam ta ndajmë këtë fitore me atë. E gjithë skuadra ndjen të njëjtën gjë", deklaroi Pekerman. Mbrojtësi kolumbian, Andres Eskobar u vra 10 ditë pasi shënoi një autogol në ndeshjen kundër SHBA në Kupën e Botës 1994. "Kemi marrë disa informacione, por nuk mund të konfirmoj asgjë. Futbollisti u ndikua shumë thellë, dhe unë mendoj se të gjithë ne e kuptojmë që futbolli është një gjë krejtësisht ndryshe. Këto gjëra as që duhen thënë me zë të lartë. E konfirmuar ose jo, kjo është diçka shumë e dhimbshme", u shpreh trajneri i Kolumbisë.



## Ndryshohet topi për fazën me eliminim direkt

Dita e enjte do të jetë e fundit për fazën e grupeve në Kupën e Botës Rusi 2018. Shumë risi do të ketë në këtë fazë. Përveç zëvendësimit të katërt, që mund të bëhet në vazhdimë, në këtë raund do të ketë edhe një tjetër risi. Prodhuesi "Telstar Machta" ka menduar se në këtë fazë ky top

të ketë një tjetër pamje më interesante, me ngjyrë të kuqe dhe të artë. Deri më tani janë mësuar vetëm dy çifte për fazën e eliminimi. Rusia do të luajë përballë Spanjës, ndërsa Portugalia me Uruguain. Dje u mësohet katër skuadra të tjera që do të kalojnë fazën e grupeve.

LIND NJË TEORI E KOMPLOTIT NË BOTËTOR

## Rusët humbën qëllimisht nga Uruguai!



Rusia ka pësuar humbje në takimin e fundit të grupit A të kampionatit botëror. Rusët kanë humbur kundër kombëtares së Uruguait me rezultat të thellë prej

3-0, e cila gjë i kushtoi të renditet në vendin e dytë të grupit. Por, së fundi po qarkullon në mediat e huaja se kombëtarja ruse ka humbur qëllimisht kundër uru-

guaianëve. E gjithë kjo bazohet në golin e Luis Suarezit nga gjuajtja e lirë, ku një lojtar rus i "pastron murin" dhe sulmuesi një gol të bukur. Por, nëse këtë e kanë bërë që t'i shmangen ballafaqimit me Spanjën në të 1/16 e finale, atëherë kanë gabuar pasi që pikërisht me spanjollët do të takohen në këtë fazë të kampionatit. Ndërkohë, Spanja ka barazuar me Marokun me rezultat 2-2, ashtu sikurse Portugalia kundër Iranit, 1-1, e cila gjë ka bërë që spanjollët të takohen me rusët ndërsa portugezët me Uruguain. Për më tepër shikoni videon e më poshtme he vlerësojeni vetë këtë situatë të pazakontë.

## Goli që i mori jetën trajnerit egjiptian

Ish trajneri egjiptian Abdel Rahim Mohamed ka pësuar një atak kardiak në momentin kur Egjipti ka pësuar golin e dytë nga Arabia Saudite, gol i cili vendosi fitoren e skuadrës nga Lindja e Mesme. Mohamed ishte angazhuar si komentues sportiv në një media në Egjipt për Kupën e Botës. Ai mori një goditje të fortë në zemër pas golit në minutën e pestë shtesë në ndeshjen Egjipt-Arabi. Ai u dërgua menjëherë në spital por pas 30 minutash ai ka ndërruar jetë. Pas ndeshjes të gjithë morën vesh lajmin për goditjen në zemër të Mohamed, i cili më parë ka qenë edhe trajner. Homologu i tij, Hek-



tor Kuper u shpreh se shpreson që Mohamed t'i mbijetojë asaj goditje në zemër, por ishte tepër vonë.

RRËFIMI PREKËS I VALON BEHRAMIT

# MË MIRË NJË VALON I ZAKONSHËM NË MITROVICË, SESA NJË YLL FUTBOLLI NË ZVICËR

"Do habiteni, por unë kisha dashur Valonin e zakonshëm në Mitrovicë. Natyrisht që unë kam një jetë mjaft të mirë këtu dhe kam të ardhura të majme. Jam gjithashtu me fat që jam zviceran dhe shumë falënderues njëkohësisht", thotë Behrami

Dikur vetë si refugjat, tani ylli i futbollit, Valon Behrami, tregon për ngjarjet e fundit në kufijtë evropianë dhe historinë personale, shkruan "Tagesanzeiger.ch".

**- Refugjatët që janë rrugëve të Ballkanit dhe kërcënohen nga vdekja si pasojë e kalimit të lumeneve dhe të ftohtit: Valon Behrami, çfarë ndjeni kur shikoni këto skena?**

**Behrami:** Fotografitë janë tepër dëshpëruese. Ne nuk dimë historinë e këtyre personave, por mund të themi plot saktësi: nëse ndokush kalon nëpër këto peripeci, natyrisht se vuan për ekzistencë. Atëherë ai largohet në një tjetër realitet, që është shumë më i rrezikshëm dhe i keq sesa ajo që shohim në fotografi. Ata njerëz janë në luftë për ekzistencë. Ne shpesh flasim për "luftë", qoftë edhe në futboll. Kur shikojmë fotografi të tilla, turpërohem i gjithë.

**- Fotografi të tilla shohim thuasjse përditë. A është kthyer në normalitet kjo tragjedi?**

**Behrami:** Emocionet sot janë mjaft të ndryshueshme. Mbi të gjitha ka të bëjë me rrjetet sociale. Diku lexon: 40 persona janë mbytur në Detin Mesdhe. Dikush poston menjëherë një fotografi dhe shkruan: "Unë lutem për diçka. Dhe dy minuta më vonë ai merr në dorë një gotë shampanjë, dhe fillon të flasë për dëshirat ditore, se çfarë këpucë do blejë. Ky temp është kthyer në një problem të vërtetë. Gjithmonë e më pak njerëz merret me çështjet më të rënda. Sepse për këtë ka nevojë për kohë dhe është e paretshme të flasësh. Dhimbje e madhe.

**- Dhe ju ndjeni dhimbje?**

**Behrami:** Për mua është e rëndësishme të kem kohë. Gjithashtu kohë për dhimbje. Unë i njoh



ata. Në të njëjtën kohë unë nuk jam i ndryshëm nga shumica e njerëzve: paksa egoist. Edhe unë mendoj herën e parë për familjen time dhe për veten. Kjo është arsyeja, pse bota nuk është në rrugën e duhur.

**- Bota do ishte më e mirë, nëse do ndanim dhimbjen me njëri-tjetrin?**

**Behrami:** Do thosha kështu: Shumica e njerëzve fillon ta shqyrtojë një problem kur troket në derën e tij. Kjo do të thotë: Vetëm kur refugjatët vijnë këtu, fillojmë të mendojmë për ata. Derisa dhimbjet e refugjatëve i shohim përmes videove ose fotografive, kjo tejkalohet shpejt.

**- Kur ju shikoni këto fotografi, mendoni për arratisjen tuaj nga Kosova?**

**Behrami:** Atëherë më vijnë lajmet e të afërmve të mi. Babai im, motra ime dhe unë u arratisëm nga Kosova në kohën kur nuk kishte akoma luftë. Luftën e vërtetë e përjetuan të afërmit e mi. Nëse dëgjon ata sesi kanë fjetur natën nëpër male, sesi i kanë dëgjuar fishkëllimat e raketave dhe nuk dinin se ku do shpërthente ajo – atëherë tregojnë vetë sytë dhe emocionet e tyre – ata e kanë përjetuar shumë thellë dhe nuk duhet të harrohet kurrë. Nuk kam pasur përjetime më të këqija.

**- Por detyrimi për tu arratisur, për të ikur. Këtë ndjenjë ju e keni përjetuar?**

**Behrami:** Këtë po. Por këtë nuk e shoh shumë dramatike. Isha shumë i ri – pesë vjeçar. Kujtimet e mia janë pozitive: Zvicra na ka mikpritur. Ishim shumë me fat. Përjetuam një Zvicër me duar të hapura. Për këtë mendoj shpesh, kur shikoj fotografitë e refugjatëve të sotëm:

Ju uroj atyre gjithashtu një Zvicër, që më priti mua me duar të hapura.

**- Cilat janë kujtimet tuaja të para në rrugëtimin drejt Zvicrës?**

**Behrami:** Ne udhëtuam me një autobus nga Mitrovica në Zvicër. Në 4 dhjetor 1990 arritëm në Tessin. Erdhëm drejt Bellinzonas dhe u vendosëm në një hotel. Kjo më kujtohet shumë mirë: ishte shumë ftohtë dhe kishte shumë vende parkimi përpara hotelit.

**- Nuk ishte ndonjë hotel i bukur, siç qëndroni momentalisht?**

**Behrami:** Jo, nuk ishte (qesh). Megjithatë mua më pëlqen secili hotel, nëse ka diçka për të ngrënë, pavarësisht se gatimet e shtëpisë më pëlqejnë më shumë. Gjatë vendosjes tonë në dhomën e hotelit, filluam të dëgjojmë një kasetë me muzikë të vjetër shqiptare.

**- Kur ishte ai momenti kur thatë: tani jemi të sigurt?**

**Behrami:** Për babin ishte ky moment – për mua jo, unë isha i vogël. Për babin tim ishte rrezik në Kosovë, sepse nga sulmet policore çdoherë si shënjestër ishin burrat. Babai im në Zvicër përsëri ndjehej i qetë. Në të njëjtën kohë ai kishte presion. Në ndodheshim në një rreth tërësisht të ri, dhe nuk e dinim sesi do ishte e ardhmja.

**- Pse ishte bërë e rrezikshme për babin tuaj në Kosovë?**

**Behrami:** Në fund të viteve 1980-të ishte bërë gjithmonë e rrezikshme për shqiptarët në Kosovë. Ata ishin të shantazhuar, nuk futehin nëpër punë si dhe dhunohehin e kërcënoheshin nga policia. Një ditë babai im erdhi në shtëpi dhe tha plot i vendosur: Ne duhet të largohemi.

**- Çfarë punonin atëherë prindërit tuaj?**

**Behrami:** Babai im ishte drejtor i një firme plastike. Nëna ime ishte sekretare. Kishim një jetesë të mirë. Nëse nuk do fillonte lufta ne do kishim mbase përsëri një jetë normale dhe unë një rini të zakonshme.

**- Çfarë do zgjidhnit? Jetën e zakonshme në Mitrovicë ose jetën si yll futbollit në Zvicër?**

**Behrami:** Do habiteni, por unë kisha dashur Valonin e zakonshëm në Mitrovicë. Natyrisht që unë kam një jetë mjaft të mirë këtu dhe kam të ardhura të majme. Jam gjithashtu me fat që jam zviceran dhe shumë falënderues njëkohësisht. Në të njëjtën kohë lufta na ka sjellë shumë fatkeqësi në familjen time. Disa nga farefisët e mi janë vrarë, disa kanë humbur gjithçka. Më shumë do dëshiroja, që kurrë mos ndodhte kjo, dhe të rriteshim si një familje e madhe.

**- Çfarë pune kishin prindërit tuaj në Zvicër?**

**Behrami:** Babai im paketonte suxhuk në frigorifer, ndërsa nëna ime punonte në një fabrikë për prodhimin e cilindrave për automjete. Më pas ajo u bë pastuese. Jetonim në Ligornetto, prindërit punonin në Stabio, rreth katër kilometra larg. Për të kursyer para, përditë shkonin e vinin në këmbë. Unë dhe motra ime qëndronim vetë në shtëpi. Motra ime kujdesej për mua, sepse ajo ishte nëntë, ndërsa unë shtatë vjeç. Njëherë e qëllova motrën time në kokë dhe filloi hemarogji. Ajo thirri nënën dhe ajo vraponte për në shtëpi. Për nënën time kishte qenë një kohë e vështirë. Ajo duhehe të punojë dhe në të njëjtën kohë të kujdeset për fëmijët.

**- Mjeku më pas ndali hemorragjinë?**

**Behrami:** Fatmirësisht kaloi pa mjek. Prej atëherë nuk i besoj shumë kokës (qesh me të madhe).

**- Shumë vjet në Zvicër keni jetuar me frikë: tre herë është vendosur që familja juaj të largohet drejt Kosovës?**

**Behrami:** Prindërit e mi kërkonin gjithmonë një jetë më të mirë për ne. E dija se për ta ishte shumë e vështirë. Megjithatë, çdoherë kam qëlluar me fat. Kisha një jetë të thjeshtë, por normale. Unë dhe motra ime shkonim në shkollë, por më e bukura ishte: ne ishim gjithmonë bashkë. Një shtëpi e vogël ka anët e saj të mira: gjithmonë je afër. Dhe ne kishim vërtet një shtëpi të vogël.

**- Ju e ndanit dhomën me motrën tuaj?**

**Behrami:** Ne flinim të katër në një dhomë. E kuptoja se jetonim në kushte të vështira, përkundër që prindërit asnjëherë nuk bisedonin për këtë. Pavarësisht se çfarë do ndodhte, ne do ishim bashkë. Kjo më ka ndihmuar edhe në futboll. Unë përpiqem 100 për qind, atëherë kur është e rëndësishme dhe nëse nuk shkon, atëherë e pranoj rezultatin. Ka sende që nuk bëhen. Prindërit e mi thoshin: 'Ne do bëjmë gjithçka për të qëndruar. Por nëse nuk bëhet, atëherë nuk bëhet'.

**- Gjatë 1998 u vendos që ju të qëndroni në Tessin. A e dinit si qëndronte puna me të afërmit tuaj në Kosovë?**

**Behrami:** Jo! Nuk e dija sesi ishin ata, gjatë shumicës së kohës kur ishte lufta. Kontakte mobili nuk kishte. Vetëm lexonin shtypin ditor, ku një raketë kishte vrarë 20 persona, pikërisht aty ku jetonin të afërmit tonë. Atëherë vuanim dhe shpresonim shumë. Kishte muaj të tërë, derisa merrnin vesh për ndonjërin se jetonte akoma.

**- Nuk kishte lidhje direkte me telefon?**

**Behrami:** Jo. Të afërmit duhet të shkonin në qytet për të telefonuar. Por kjo mund të bëhej vetëm gjatë ditës.

**- Si fëmijë ishit xheloz ndaj kolegëve që kishin kushte më të mira dhe kishin më pak shqetësime?**

**Behrami:** Atëkohë isha i kënaqur me pak. Fitoja diçka të vogël dhe kënaqesha gjithë ditën me atë. Sot fëmijët kanë 120 lojëra dhe kërkojnë më tepër dhe më tepër (qesh). Mbase është normale. Njeriu përshtatet me realitetin, ku rritet si fëmijë.

**DASHI** 21. mars - 20. prill  
Kjo është një ditë gjatë së cilës do të jeni tejet emotiv, arsye për të cilën duhet të shmangni çdo situatë të tensionuar. Parashikohet një e martë mjaft e frytshme për të mbyllur disa negociata, të shtyra në kohë. Këshillohet që të mos tregoheni të nxituar.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
Parashikohet një ditë e cila do ju gjejë mjaft pozitiv dhe të palodhur në vendin tuaj të punës. Për këtë arsye mos u druani të nisni projekte të reja, të cilat do të rezultojnë mjaft të frytshme. Në dashuri, mos u tregoni grindavec.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
Mundohuni që t'u jepni fund atyre konflikteve që zgjasin prej shumë kohësh dhe që ju tensionojnë. Kjo është periudha më e mirë për të bërë paqe, me persona me të cilët keni kohë pa folur.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
Do të jeni të detyruar që të merrni vendime të rëndësishme në një kohë shumë të shkurtër dhe kjo gjë do ju fusë në krizë. Megjithatë mos u dekurajoni, por besojini intuitës suaj, e cila do ju lejojë që të arrini objektivat që i keni vendosur vetes. Raporti në çift do të jetë harmonik.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
Kjo e martë do të jetë e rëndësishme për të rigjetur ekuilibrin dhe stabilitetin emocional. Këshillohet që të reflektoni dhe kjo gjë do ju lejojë që të analizoni me shumë kujdes, të gjitha situatat, të cilat së fundmi ju kanë vendosur në siklet. Në dashuri këshillohet të jeni më aktiv, në mënyrë që të bëni për vete një person që pëlqeni.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
Disa ndryshime të minutës së minutit do ju përballin me vështirësi, megjithatë mos lejoni që ankthi t'u bllokojë, për shkak se do të keni mënyrë për t'u përmirësuar. Në familje dhe në raport me parnter/en, mos u tregoni shumë kokëfortë.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
Nga pikëpamja sentimentale kjo është një javë me shumë fat. Pritet të ketë takime të reja dhe interesante. Mundohuni vetëm që të tregoheni më të përfshirë në vendin tuaj të punës.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
Zgjuarsia dhe kreativiteti juaj do ju vijnë në ndihmë, për të zgjidhur disa keqkuptime të vogla në vendin tuaj të punës. Kjo ditë është mjaft e favorshme, për të marrë në dorë karrierën tuaj. Dashuria parashikohet mjaft e favorshme.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
Do ju duhet të sforcoheni për t'u shfaqur më të qetë dhe reflektues, sidomos nëse në vendin e punës po jetoni një situatë të tensionuar. Shmangni konfliktet dhe mos e reflektoni tensionin në raportin në çift. Nëse jeni të pavendosur mes dy lidhjeve, ndiqni zemrën tuaj.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
Kjo ditë do ju lejojë që të prisni mundësitë që do shfaqen para jush, duke përmirësuar jetën personale dhe atë profesionale. Në vendin e punës parashikohen eksperiencat të reja. Dashuria do të jetë mjaft e favorizuar.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
Do të keni mundësi që të lidheni me shumë me një person që e njihni fare pak dhe do të zbuloni se keni shumë gjëra të përbashkëta. Bashkëpunimet e reja do të rezultojnë mjaft të frytshme për karrierën tuaj profesionale. Kjo ditë favorizon takimet.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
Gjatë kësaj dite do të shijoni rezultate të mëdha, sidomos nga pikëpamja profesionale, ku do të rifuteni plotësisht në lojë. Megjithatë në dashuri dhe në familje do të jeni disi të ftohtë dhe të shkëputur. Përfitoni për të kaluar me shumë kohë cilësore së bashku.

MENSUR MAMUTI	AKTORJA FRENDE NË FOTO	FILM I AKTORES NË FOTO	SHKRETËTIRË NË KILI	KLUBI FUTBOLLI SHQIPTAR SKLLAVI	D
MË I MIRI, KAMPIONI					
E NËNSHTRON DIÇKA, E BËN ZAP					
QYTEZË (TUR.)					
K					
URATË					
KËNGËTARJA JONË, ZARI				ZERO KRYENEÇËSIA	
KUFI					
KRYEQYTETI I JORDANISË					
XHI			FLORI MAFIOZI I NJOHUR ITALO-AMERIKAN		
AMPERI		PËREMËR VETOR AKOMA			SHTET NË EVROPË (NË JUG TË KAUKAZIT)
LLOJ KAFEJE VENDORE					DERA QYTEZË NË ITALI SPORTI "I BARDHË"
NGJYRË (ANG.)				NDEZJE ESHTRASH SHPËRBLIM FRENK I FILMIT, AKTORJA NË FOTO E FITOËS HËRE	
KOHA	MAÇOK RRUZULLI			FILM I AKTORES NË FOTO NJË GJUAJTJE NË FUTBOLL	
BANORI I NJË QYTETI SHQIPTAR					
OKSIGJENI		GAZ, OKSIGJENI I KONCENTRUAR AMERICIUMI			ILIRIANA SULKUQI HËNË E JUPITERIT
MARIHUANA					TEMPERATURA METRI
AMERIKAN				PJESË E MOLEKULËS	



NE KETE DATE

ZGJIDHJET: D, NADIRI, NIKOS, AT, MK, LËFAR, ITENE, ZBRET, DAUM, J, RAXHA, KAMEO, NEKROLOGD, I PARI, ZOTON, KASABA, BEKIM, EDA, O, LIMIT, AMANI, XHI, AR, A, ATA, P, T, NELINA, OPI, INK, ARTRIT, DAC, METRO, TEPPELENASI, O, OZONI, IS, KANABISI, T, AMER, ATOMI.

**Shumë i lehtë**      **Sudoku**      **mesatar**

8				3	5					2			9	8			6	4
		1	4	7						9					3			
	5	4							1				7					
1				4					8		4							6
4	6		3		7				9	1	6					9		1
	8			1						3			5					
								4	5		1			3				8
		2		5	4	1					7	8		4				
			8	9						6			6			5	1	7

Shumë i lehtë: 826135974, 391472865, 754968312, 139246587, 465387291, 287519643, 618723459, 972654138, 543891726. Mesatar: 237981564, 914653782, 568724139, 341279856, 672538941, 895146273, 159367428, 783412695, 426895317.

## Astronauti amerikan padit fëmijët dhe ish-menaxheren e tij



Astronauti amerikan Buzz Aldrin, është duke paditur dy fëmijët e tij dhe ish-menaxheren, nën akuzën se ata kanë keqpërdorur para nga ai dhe kanë dëmtuar trashëgiminë e tij përmes shpifjeve. Padia është dërguar një javë pasi fëmijët e tij kërkuar që t'i kenë nën kontroll financat e tij. Anëtarët e familjes së tij thanë para gjykatës së Aldrin ka nevojë për kujdestar sepse ka "rënie të aftësive njohëse", raporton BBC, përcjell ksp. Në padi ai pohon se vajza dhe djali i tij, si dhe ish-menaxherja kanë nënvlerësuar edhe "marrëdhëniet personale romantike" të tij duke ja ndaluar atij martesën. 88 vjeçari ka qenë njeriu i dytë që ka ecur në sipërfaqen e hënës.

## Hamburgeri "bishë" që peshon 7 kg



Një restorant në Las Vegas ka vendosur që të shtojë në menunë e tij një hamburger të stërmadh. "Truffles n Bacon Café" është kthyer në destinacion turistik falë hamburgerit që peshon rreth 7 kg dhe që mund të ngopë plot 7 persona për 85 dollarë. Me dy bifteke të mëdhenj sa një picë, ky hamburger ka edhe mish derri, domate dhe patate, pa përmendur

këtu shumë salca pikante. E gjithë kjo mbushje mbulohet me djathë dhe 4 vezë të skuqura. Ndërsa buka është e lyer me majonezë pikante koreane. Pronari i restorantit amerikan, Jackie Lim tha: "Është një hamburger që zëvendëson tortën e ditëlindjes. Unë ushqimin nuk e marr seriozisht. Mendoj se ushqimi duhet të jetë argëtues".

## Prifti bën rep në kishë, e pezullojnë

Një prifti katolik në Kenia i është hequr e drejta për të udhëhequr meshat kryesore publike për një vit, sepse ai këndoi rep gjatë predikimeve. Është eprori i tij ai që ka bërë të ditur lajmin për BBC, transmeton Shqip. Sipas tij, Ati Paul Ogallo, i cili ishte mbiquajtur "Sweet Paul", duhej "të zgjidhte mes të qenit një rreper ose një prift". "Shenjtorët dhe laikët nuk mund të përzihen", shtoi Peshkopi Philip Anyolo, i Dioqezës së Homa Bay në Kenian perëndimore. Por peshkopi këmbënguli se Ati Ogallo mund të përdorte rreperin për t'u predikuar të rinjve – jo vetëm nga altari. Pas masës ndëshkimore, Ati Ogallo ndryshoi rrobat e priftit me ato të rreperit, si T-shirt dhe pantallona të gjera.

Duke shpjeguar alteregon e tij, ai i tha



kryesor gjatë meshës publike ose të administruarë kungimin e shenjtit, por lejohet të udhëheqë një meshë private. Ati Ogallo nuk ka komentuar pezullimin e tij.



## Rita Ora nuk harron ushqimet tradicionale shqiptare

Këngëtarja e famshme me origjinë nga Kosova, Rita Ora ka provuar ushqime të ndryshme në të gjithë botën por duket se nuk i lë ushqimet tradicionale shqiptare. Me anë të një postimi në Instagram Stories, ajo ka treguar se nëna e ka mësuar të dojë vendin dhe disa prej gatimeve të njohura. "Në shtëpi me nënën, pite", ka shkruar ajo në fotografinë e publikuar. Kujtojmë se bukuroshja shqiptare është përfolur kohët e fundit për lidhjen e dashurisë por nuk ka dhënë ende një deklaratë për historinë e re. Ndërkohë vijon turneun e saj muzikor që po pritët mjaft mirë.



KALENDARI HISTORIK 27 QERSHOR

1358 - Themelohet Republika e Dubrovnikut.  
1693 - Beteja e parë detare e Lagos: Anglia dhe Holanda kundër Francës.  
1914 - SHBA nënshkruan marrëveshje tregtare me Etiopinë.  
1940 - Ushtria sovjetike sulmon Rumaninë.  
1954 - Rebelët e sponsoruar nga CIA rrëzojnë qeverinë e zgjedhur në Guatemalë.  
1960 - Somalilandi britanik bëhet pjesë e Somalisë.  
1969 - Honduras dhe El Salvador ndërpresin marrëdhëniet diplomatike për shkak të një ndeshjeje futbollistike.  
1977 - Xhibuti (Afars & Issas) shpall pavarësinë nga Franca.  
1998 - Hapet Aeroporti Ndërkombëtar i Kuala Lumpur në Malajzi.

Ernest Hemingway ka pranuar se ka ndryshuar faqen e fundit të romanit "Lamtumirë armë" e ka ndryshuar 39 herë.



Grupi Beatles ka patur dy anëtarë që kanë qenë të mëtijë – Pol Mekartni dhe Ringo Star



Kafja për herë të parë është përmendur rreth vitit 1000. Në fillim ajo është përdorur si ilaç, e më pastaj në Persi dhe vendet arabe kanë filluar ta pinë si pije të rregullt.



### TAKSISTI

Në stacionin e trenit në Edinburg një skocez, i shoqëruar me gruan dhe katër fëmijët, i afrohet taksistit:  
– Sa kërkon që të na çosh në shtëpi?  
Nuk është larg. Nga këtu ka vetëm katër kilometra.  
– Një funt për të ty; një për shoqen tënde, kurse për fëmijët asgjë.  
Skocezi mendoi një çikë dhe iu drejtua fëmijëve:  
Hyni ju të katër fëmijët në taksë, kurse unë dhe mamaja juaj i hipim autobusit.

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Detyra e një patrioti të vërtetë është ta mbrojë vendin e tij nga qeveria e tij.

**THOMAS PAINE**